

*Doc. Dr. Arzu T. Terzi-Istanbul*

## **ZEJE NË QYTETIN E PRISHTINËS\***

Në konceptin qytetërim jeta e qytetarit ka një hisë të rëndësishme. Treguesi më i rëndësishëm i urbanizimit (të qenurit qytetar) është të liruarit e individëve nga varshmëria që kanë nga toka, domethënë, pos bujqësisë e bagëtisë, është zgjedhja e zejeve të ndryshme me të cilat do të merren dhe që do t'i mbulojë të gjitha llojet e nevojave të vendit, madje edhe të rrethit në të cilin gjenden. Duke u nisur nga kjo pikë, për këtë punim, nga Ballkani, si model është zgjedhur qyteti i Prishtinës dhe janë analizuar llojet e zejeve që janë ushtruar këtu në mesin e shekullit XIX, si dhe ndarja e tyre. Burimi i shfrytëzuar për këtë temë është Defteri i të ardhurave (Temettuat Defteri) i Prishtinës, që gjendet në Arkivin Osman të Kryeministrit.<sup>1</sup> Në këtë defter prej 245 faqesh i cili përmbledh rezultatet e regjistrimit të pronave e të tokave, që është bërë në qytetin e Prishtinës më 1844, gjenden regjistra origjinale ku ka shumë të dhëna të rëndësishme: emrat e kryefamiljarëve të shtëpive muslimane e jomuslimane që jetojnë në qytet, zejet, fitimet, pronat e paluajtshme të tyre e deri tek tatimet që paguanin.

Prishtina në periudhën që kemi analizuar, është qendër kaza e sanxhakut të Prishtinës, që i përkiste vilajetit të Shkupit. Si rezultat i rregullimit të ri me organizimin osman të administrimit në provinca pas Tanzimatit, në këtë qytet vendoset kajmakami, i ngarkuar me detyrë të administratorit të sanxhakut.

Kur të analizohet struktura demografike e Prishtinës, shihet se në qytet kishte 779 shtëpi muslimane, që banonin në 12 mëhallë. Emrat e mëhallëve dhe ndarja e tyre sipas numrit të shtëpive, shihet në tabelën I. Sipas kësaj, mëhalla më e dendur ishte mëhalla Jusuf Efendi që kishte 118 shtëpi, ndërsa mëhalla Xhami-i Sagir (Xhamia e vogël), ndoshta për shkak se ishte njësia e banuar më e vjetër e qytetit,

---

\* Kumtesë e lexuar në Simpoziumin e Dytë Ndërkombëtar: "Qytetërimi Islam në Ballkan" mbajtur në Tiranë prej 4-7.

<sup>1</sup> Başbakanlık Osmanlı Arşivi, *Maliye Nezareti Temettuat Defterleri*, nr. 15465.

ishte mëhalla më e vogël. Kajmakami Abdurrahman pasha banonte në mëhallën Xhami-i Kebir (Xhamia e madhe).

Ka 239 shtëpi të regjistruara në defter si raja (shtetas jomuslimanë të Perandorisë Osmane; fig. të krishterë), që janë banorë të krishterë. Një pjesë e këtyre banorëve banojnë në formë kolektive në dy mëhallët që janë në varoshin<sup>2</sup> e qytetit. Sipas kësaj, në mëhallën varosh që gjendet pranë mëhallës Jarar Çeribash, ka 41 shtëpi të krishtera, ndërsa në mëhallën Varosh që gjendet afër mëhallës Hasan Bej, 94 shtëpi. Banorët e krishterë të 104 shtëpive të tjera jetojnë të shpërndarë në vende të ndryshme të qytetit.

Në qytet ka 122 shtëpi romësh. Prej tyre 63 janë muslimanë e 59 të krishterë. Pës këtyre, në Prishtinë ka 6 shtëpi hebrejsh.

Struktura demografike në qytet shumë shihet më qartë në grafikonin që është në tabelën II. Sipas kësaj, në qytetin e Prishtinës, kishte gjithsej 1146 shtëpi, bashkë me muslimanët romë jetojnë gjithsej 842 shtëpi muslimane, 289 shtëpi të krishtera, ku përfshihen edhe të krishterët romë dhe 6 shtëpi hebrejsh. Prandaj, 73 % të banorëve të Prishtinës e përbëjnë muslimanët, 26% të krishterët dhe 1% hebrejtë. Nëse nisemi nga hipoteza se çdo shtëpi do të mund të kishte 5 veta, mund të thuhet se numri i përgjithshëm i banorëve të qytetit të Prishtinës në vitin 1844 ishte përafërsisht 6.000.

Kur bëhet një ndarje në vija të trasha sipas profesioneve me të cilat merreshin kryefamiljarët e 1146 shtëpive që jetonin në qytetin e Prishtinës, përballemi me një tabelë që përbëhet nga pesë grupe të veçanta, si: esnafë e zanatlinj, nëpunës, ata që merren me bujqësi e bagëti, punëtorë dhe ata që nuk kanë kurrfarë profesioni.<sup>3</sup>

Nëpunësit zyrtarë të cilët përbëjnë 14% të kryefamiljarëve në qytet, janë personat që shërbejnë në këto sfera: administratë, ushtri, sociale dhe fetare. Këta janë komandantë të eskadronit, rabinë, imamë, kadinj, qahjallarë, qatipë, kajmakamë, muderrizë kazaje, kmetë, mësues fëmijësh, muhtarë (kryeplak), regjistruer njerëzish, mbikëqyrës të njerëzve, priftërinjë, ushtri kufitare, mbikëqyrës i ujit në qytet (subashi), kalorësit e timarit dhe zaptinjtë (xhandarmëria), që do të thotë 18 profesione. Detyra e qahjaft dhe e mbikëqyrësit të ujit, që zënë vend në kuadër të këtyre detyrave, nuk janë zyrtare dhe ata duhen pranuar si administratorë të veçantë. Fakti që në Defterin e të ardhurave, që është burim i punës, është i shkruar paragrafi se nga pjesa më e madhe e gjithsej 16

<sup>2</sup> Varosh është quajtur pjesa që gjendej jashtë kalasë së qytetit e kasabasë, me shumicë këtu janë mëhallët e krishtera. (Shemseddin Sami, Kamus-i Turki, s.1482).

<sup>3</sup> Shih: Tabela III: Klasifikimi i kryefamiljarëve sipas profesioneve.

mbikëqyrësve të ujit që jetonin në qytet, “të ardhurat ishin nga qahjallëku i çiftllëkut”, kishte nxitur mendimin se termat mbikëqyrës i ujit dhe qahja janë përdorur në vend të njëri-tjetrit.<sup>4</sup>

Në mesin e grupit të nëpunësve personi më i rëndësishëm që tërheq vëmendjen, është kajmakami i sanxhakut të Prishtinës Jashar pashazade Abdurrahman pasha. Abdurrahman pasha është personi më i pasur i qytetit. Ky person, i cili banonte në mëhallën Xhami-i Kebir, numër 1, kishte të ardhura vjetore gjithsejt 78.198 kurushë, që ishin nga vakëfi Jashar pasha, nga qiratë prej pasurisë së paluajtshme dhe nga qiratë e çiftllëkut dhe nga xhizja (tatim për kokë banori) që merrte nga romët. Këto të ardhura përbëjnë gati 10% të të ardhurave të përgjithshme të qytetit, që është një shumë mjaft e madhe.

121 kryefamiljarët që merren me bujqësi e bagëti, në defter janë të regjistruar me emra si: vreshtar, kopshtar, bujk, çoban, lopar, ekspert bujqësor dhe rençber. Fjala rençber në këtë provincë nuk përdoret me kuptimin punëtor bujqësie, por si “pronar toke që merret me bujqësi dhe me bagëti”.

Punëtorët, të cilët përbënin 12% të kryefamiljarëve që jetonin në qytet, në Defterin Temettuat janë regjistruar me emrat: punëtor shati, shërbëtor, argat dhe meditës. Pranë shpjegimit të të ardhurave të kryefamiljarëve, të emërtuar si shërbëtorë dhe meditës, nganjëherë janë dhënë shpjegime si “ai që krahas kësaj bën edhe punë – shërbim meditje”, ose në pjesën e profesionit në pjesën e të ardhurave të kryefamiljarit, ku shkruan *meditës*, janë bërë shpjegimet “ai i shërben kësaj” ose “domethënë shërbëtor”. Dhe termi i tretë që krahas këtyre dy termave përdoret me të njëjtin kuptim është *teroglanlık*. Te shërbëtorët dhe emërtimet hasen edhe kufizimet si “meditës, domethënë është *teroglan*”, “shërbëtor domethënë është *teroglan*”. Shërbëtorët dhe meditësit mund të punojnë edhe në sferën e bujqësisë edhe pranë esnafëve dhe zanatlinjve. Në fakt, tek një pjesë e meditësve është qartësuar se kishte meditës të tregtarit, druvarit, shitësit - pjekësit të kafesë, kujdestarit të kuajve, të gëzoftarit, të karrocierit, të dyqanxhiut, të bukëpjekësit.

---

<sup>4</sup> Këtë mendim tonin e vërteton edhe e dhëna se në fjalorin e Mehmet Zeki Pekalën-it *Osmanlı Tarih Deyimleri ve Terimleri Sözlüğü* (II İstanbul 1983, s. 261) midis kuptimeve të fjalës **subaşı** në Rumeli përdoret edhe kuptimi si emër që u jepet atyre që janë në post të qahjait në çiftllëqe dhe për faktin se në fjalorin *Kamus-i Turki* (s. 836-837) të Shemseddin Samiut gjendet me kuptim të qehjait së çiftllëkut. Megjithatë, shihet se shprehja qahjallëk, e përdorur në Temettuat Defteri, nuk është përdorur vetëm me kuptim të çiftllëkut, por edhe në kuptim të administruesit të një konaku apo të pasurisë së paluajtshme. Sepse, për 8 nga 12 qahjallarët që jetojnë në qytet, në defter ka shpjegime, dhe përdërisa 6 nga këta ishin qahjallarë çiftllëku, njëri është qahja mulliri, kurse tjetri është qahja i haremmit të kajmekamit Abdurrahman pasha.

Në qytet ka gjithsej 91 persona që nuk kanë profesion. Nga këta, për sa i takon çështjes së kryefamiljarit, 21 janë studentë, jetimë dhe gra. 17 janë pleq dhe sakatë, e dy dervishë. Një person është mulla Sulejmani, shërbëtor nga të nënshtruarit e kajmakam Abdurrahman pashës. Katër persona, për shkak të kundërvajtjeve të tyre, ishin dërguar në Stamboll. Të tjerët janë ata që jetojnë nga të ardhurat nga renta e mallrave që kanë.

Për sa u takon esnafëve dhe zanatlinjve që në kuadër të shpërndarjes profesionale në qytet përbëjnë pjesën më të madhe, 55%, siç do të shihet në Tabelën IV, në kuadër të 56 profesioneve të ndryshme punojnë gjithsej 634 kryefamiljarë. Edhe në Prishtinë vërehet dukuria që në kuadër të strukturës tradicionale të organizatës së esnafëve osmanë, ka të atillë që zejet e tyre i ushtrojnë bashkërisht në kuadër të së njëjtës zeje. Në fakt, nga shënimet në Defterin e të ardhurave (Temettuat Defteri) vërtetohet se në qytet kishte një pazar miell i dyqaneve të bukëpjekësve dhe tregjet e llullave, rrobaqepësve dhe i saraçëve (lëkurpunuesve).

Disa nga këto zeje, që shihen në tabelë, ushtroheshin bashkërisht nga muslimanët, të krishterët, romët e hebrenjtë që jetonin në qytet, ndërsa disa nga zejet shihet se janë ushtruar vetëm nga një kategori e caktuar, një gjendje që haset shumë në qytetin osman. Për shembull profesionet si: abaxhi (zhguntar), ambarxhi, poçar, bukëpjekës (15 sish), kallajxhi, qebapçi, qyrkçi, mejhanexhi, samarxhi, simitçi ushtrohen vetëm nga të krishterët. Ndërsa përballë këtyre si: tregti me pakicë, berberllëk, lëkuraxhillëk, zdrukthëtari, zeja e shprishjes së leshit (lënuarje), kafexhillëk përpunues i fijes së mëndafshit, mjek popullor - rregullues i frakturave, përpunues i kokave të çibukëve-llullave, libërlidhje, mbathtar (profesioni i nallbanit), shërbyese në hamamin e grave, ortaria, saraçllëk, shkruer - daktilografim, janë degë profesionesh të ushtruara vetëm nga muslimanët. Shohim se disa profesione janë ushtruar vetëm nga romët. Për shembull: punimi i hasrave, qemerxhillëku, kovëbërës, druvar dhe qymyrxhillëku, bravari, grirës duhani, kultivimi i kuajve janë degë profesionesh që më së shumi i ushtrojnë romët. Një e veçantë tjetër që tërheq vëmendjen është fakti se gjithashtu pjesa më e madhe atyre që ekzekutojnë me vegla muzikore janë romët.

Profesionet që më së shumi ushtrohen nga kryeshtëpiakët në kuadër të esnafëve dhe zejtarëve janë: karrocieri, rrobaqepësia, tregtia, dyqanxhillëku, druvaria dhe qymyrxhillëku, këpucëtar dhe berber.<sup>5</sup> Karrocieria që është një profesion në fushën e transportit është profesion që në Prishtinë është ushtruar më së shumi. Tregtarët

<sup>5</sup> Shih Tabela V: Profesionet e ushtruara më së shumti.

nuk e kishin humbur karakteristikën e të qenit profesion që në shekuj bën të fitosh më së shumti; tregtarët e Prishtinës merren me tregtinë e lëkurës, drithërave e të mallërava dhe po ashtu nga regjistrimet në Deftër, kuptohet që një pjesë e tyre bënin tregti me rroba shqiptare. Kur analizohen sallnamet (vjetarët) e fundit të shekullit 19, bie në sy se në qytet vazhdojnë ende të jenë të përhapura profesionet si: dyqanxhillëku, tuxharllëku dhe karrocëria<sup>6</sup>. Numri i madh i kryefamiljarëve, që ushtrojnë zejen e zdrukthëtarit dhe të qymyrxhiut, duhet të jetë rrjedhojë e faktit se në rajon dimrat kanë qenë të ashpra.

Në qytet prodhohen dy llojë këpucësh. Përderisa jemenijet, që ishin këpucë të çelura përsipër dhe me taka, kryesisht i prodhonin zejtarët muslimanë<sup>7</sup>, çarik (opinga) ishte një lloj tjetër i këpucëve, që në numër të vogël i prodhonin kryefamiljarët e krishterë<sup>8</sup>. Nuk duhen harruar edhe 18 mjeshtrit përpunues të lëkurëve që jemenixhinive dhe opingarëve u siguronin lëndën e parë.

Siç u theksua më lart në klasifikimin e kryefamiljarëve sipas profesioneve, në qytet esnafët dhe zejtarët përbëjnë 55% të kryefamiljarëve<sup>9</sup>. Kur kjo vlerësohet si burim i të ardhurave, vërtetohet se esnafët dhe zejtarët 62% të fitimit të tyre vjetor i siguronin nga të ardhurat e profesionit. Në të vërtetë, pjesën tjetër të të ardhurave shihet se e siguronin nga qiraja, bujqësia dhe bagëti. Sipas kësaj, të ardhurat nga qiraja përbëjnë 20% të të ardhurave të përgjithshme, nga të cilat 13% nga qiraja e tokës<sup>10</sup>, 14% nga bujqësia dhe 4% nga bagëti.<sup>11</sup>

Ndërkaq, kur analizohet shpërndarja e burimeve të të ardhurave të përgjithshme të qytetit të Prishtinës, ballafaqohemi me të dhëna edhe më të nduarnduarta. Në të vërtetë, siç shihet edhe në grafikon<sup>12</sup>, shihet se të ardhurat e qirasë kapin pjesëmarrjen më të madhe me 35%. Pjesa e të ardhurave nga qiraja, me 9%, sigurohet nga pronat e paluajtshme, si: dyqan, han, kafene, tjegullore, kolltuk, shtëpi publike që ekzistojnë në qytet. Pjesa e të ardhurave nga qiraja me 25% është qiraja nga toka. Tokat e quajtura çiftllëqe të kryefamiljarëve që jetojnë në qytet, po të cilat janë në fshatrat që i përkasin Prishtinës ose në kazatë fqinje, punohen nga njerëz të caktuar, dhe pasi të hiqet sasia e të dhjetës nga prodhimi vjetor, nga sasia

---

<sup>6</sup> 1304 *Tarihli Kosova Salnamesi*, s.86; 1314 *Tarihli Kosova Salnamesi*, s. 346-347.

<sup>7</sup> Në fakt nga 27 mjeshtër prodhues të jemenijeve që jetonin në qytet vetëm një ishte i krishterë.

<sup>8</sup> Në qytete ishin katër mjeshtër të krishterë të opingave.

<sup>9</sup> Shih Tabela III.

<sup>10</sup> Shprehja qiraja e tokës do të shpjegohet në vazhdim. 147 kryefamiljar të ardhurat i sigurojnë nga qiraja e tokës.

<sup>11</sup> 342 kryefamiljar esnaf posedojnë bagëti.

<sup>12</sup> Shih: Tabela VI: Shpërndarja e fitimeve në qytet.

e pastër e mbetur, një e pesta i dërgohet pronarit të tokës. Ja, pra, pjesa e fitimit prej 26% krijohet nga këto, një të pesta, dhe 356 kryefamiljarë që jetojnë në qytet kanë të ardhura nga qiraja e këtillë e tokës. Kjo gjendje nxjerr në shesh se këta kryefamiljarë, çfarëdo profesioni që të kenë, janë pronarë të tokave dhe se nuk i kanë këputur lidhjet e tyre me pronat e tyre të tokës.

Nga ana tjetër, të ardhurat e realizuara nga të mbjellat e të korrurat në fushë, vreshtë, kopshte e livadhe, janë 17%. Ndërkaq fitimi i realizuar prej 4% nga bagëtia, që shihet në grafikun, nuk e pasqyron sasinë reale. Sepse 645 kryefamiljarë që jetojnë në qytet, domethënë 56%, kanë të ardhura nga bagëtia. Në Defterin e të ardhurave, krahas shumë kafshëve të regjistruara, si: lopë, dele, dhi, buall, pelë, është menduar një regjistër i të ardhurave që do të merren pas 1, 2 apo 3 vjetve. Prandaj, është e qartë se kjo shkallë do të rritet më së voni brënda tre vjetve.

Kështu, si rezultat del se në vitin 1884 gjithsej 1146 kryefamiljarë që kishin jetuar në qytetin e Prishtinës, kishin ushtruar 85 profesione të ndryshme. Si një nevojë e urbanizimit, esnafllëku dhe zejtaria janë profesionet e ushtruara më së shumi në Prishtinë. Por, megjithatë, brenda periudhës së analizuar, shihet qartë se për popullatën e qytetit të Prishtinës, toka si një element i pashmangshëm, ruan vendin e vet në kuadër të jetës në qytet.

Tabela I

**Mëhallat muslimane dhe numri i shtëpive në qytetin e Prishtinës**


|    | <b>Mëhallat</b>               | <b>Numri i shtëpive</b> |
|----|-------------------------------|-------------------------|
| 1  | Xhamia e vogël (Cami-i sagir) | 27                      |
| 2  | Mehmed Bey                    | 29                      |
| 3  | Pirnazir                      | 35                      |
| 4  | Yarar Çeribaşı                | 38                      |
| 5  | Hasan Bey                     | 54                      |
| 6  | Hasan Emin                    | 61                      |
| 7  | Xhamia e madhe (Cami-i kebir) | 67                      |
| 8  | Yusuf Çelebi                  | 70                      |
| 9  | Hatuniye                      | 79                      |
| 10 | Ramazaniye                    | 92                      |
| 11 | Alaaddin                      | 109                     |
| 12 | Yunus Efendi                  | 118                     |
|    | Gjithsej:                     | 779                     |

Tabela

II

**Ndarja e kryefamiljarëve sipas profesioneve**

|   |                                   |      |
|---|-----------------------------------|------|
| 1 | Esnaftë e zanatlinjë              | 634  |
| 2 | Nëpunës                           | 158  |
| 3 | Punëtorë                          | 142  |
| 4 | Ata që merren me bujqësi e bagëti | 121  |
| 5 | Ata që nuk kanë profesion         | 91   |
|   | Gjithsej                          | 1146 |



Tabela

IV

## Esnafët dhe zejtarët në qytetin e Prishtinës



| Nr. | Profesionet         | Nr. | Nr. | Profesionet            | Nr. |
|-----|---------------------|-----|-----|------------------------|-----|
| 1   | Zhguntar            | 4   | 29  | Qebapxhi               | 2   |
| 2   | Magaciner           | 1   | 30  | Kemerxhi               | 1   |
| 3   | Karrocier           | 99  | 31  | Qeremedxhi             | 4   |
| 4   | Gjellbërës          | 3   | 32  | Mjek popullor          | 1   |
| 5   | Tregtar me pakicë   | 2   | 33  | Përpunues kofesh       | 3   |
| 6   | Dyqan i vogël       | 45  | 34  | Qymyrxhi               | 27  |
| 7   | Druprerës           | 5   | 35  | Gëzoftar               | 9   |
| 8   | Berber              | 24  | 36  | Çubuktar               | 14  |
| 9   | Bojaxhi             | 6   | 37  | Muzikant               | 9   |
| 10  | Opingaxhi           | 6   | 38  | Mejhanexhi             | 5   |
| 11  | Trastar             | 1   | 39  | Cergëtar               | 5   |
| 12  | Çeshmexhi           | 2   | 40  | Libërlidhës            | 1   |
| 13  | Bravar              | 15  | 41  | Nallbanxhi             | 11  |
| 14  | Poçar               | 1   |     | Shërbyese në hamamin e |     |
| 15  | Çibukxhi            | 1   | 42  | grave                  | 2   |
| 16  | Lëkurpunues         | 18  | 43  | Druvar                 | 19  |
| 17  | Drugdhendës         | 3   | 44  | Sahatçi                | 2   |
| 18  | Duhanxhi            | 12  | 45  | Saraç                  | 7   |
| 19  | Zdrukthtar          | 8   | 46  | Shitës                 | 9   |
| 20  | Bukëpjekës          | 13  | 47  | Shitës samarësh        | 1   |
| 21  | Pamuktar            | 1   | 48  | Ruajtës i kuajve       | 9   |
| 22  | Hanxhi              | 4   | 49  | Simitçi                | 3   |
| 23  | Hasraxhi            | 5   | 50  | Maser ne hamam         | 1   |
| 24  | Hassas?             | 2   | 51  | Tejall                 | 1   |
| 25  | Kahvexhi            | 9   | 52  | Terzi                  | 79  |
| 26  | Kalajxhi            | 1   | 53  | Tregtar                | 66  |
| 27  | Kasap               | 13  | 54  | Përpunues i pushkëve   | 4   |
| 28  | Përpunues mëndafshi | 1   | 55  | Shkrues                | 7   |
|     |                     |     | 56  | Këpuctar               | 27  |
|     |                     |     |     | Gjithsej               | 634 |

Tabela

V

**Profesionet e ushtruara më së shumti**

|   |                          |    |
|---|--------------------------|----|
| 1 | Karrocceria              | 99 |
| 2 | Rrobaqepësia             | 79 |
| 3 | Tregtia                  | 66 |
| 4 | Druvaria e qymyrxhillëku | 46 |
| 5 | Dyqanxhillëku            | 45 |
| 6 | Këpuctaria               | 27 |
| 7 | Rrojtaria                | 24 |




Tabela

VI

**Shpërndarja e fitimeve në qytet**

|   |                             |               |
|---|-----------------------------|---------------|
| 1 | Të ardhurat nga profesionet | 204989        |
| 2 | Pagat                       | 113294        |
| 3 | Pagesa për mëditje          | 31661         |
| 4 | Bujqësia                    | 136093        |
| 5 | Bagëtia                     | 31331         |
| 6 | Qiraja                      | 274827        |
|   | <b>Gjithsejt</b>            | <b>792195</b> |



- Të ardhurat nga profesionet
- Pagat
- Pagesa për mëditje
- Bujqësia
- Bagëtia
- Qiraja

Nga turqishtja: **A. Hamiti**

## **CRAFTSMANSHIP IN THE TOWN OF PRISHTINA**

### ***Summary***

The most important indicator of urbanization is the fact that individuals are no longer dependent on the cultivation of land (i.e. along with farming and cattle breeding they can exercise different professions, through which they can meet all their needs). As a model, we have chosen the town of Prishtina and we have analyzed different professions, which were exercised in the XIX century. The main source to be used was the Temettuat Defteri, which is kept in the Ottoman Archive. The Defter has 245 pages and shows the results of the registration of property in the town of Prishtina in 1844. It also contains the names of the heads of the Muslim and non-Muslim families that live in this town, the craft they exercise, real property, etc.

*Prof. dr. Fehim Bajraktareviq*

## **NJË BURIM BASHKËKOHOR PERSIAN PËR BETEJËN E KOSOVËS**

Nuk mund të thuhet se ka shumë burime orientale për historinë e fillimit të Perandorisë Osmane dhe në përgjithësi për shekullin 14, në të cilin ajo i vendosi themelet, po ka edhe më pakë burime të tilla të cilat do të përmbanin diçka për historinë tonë të asaj periudhe. Rasti konkret ka të bëjë me vrasjen e sulltan Muratit dhe të princit Llazarit. Kjo mund të vërehet lehtë nga pasqyra e burimeve kryesore që i ka dhënë Mehmed Fuat në librin e tij të njohur *"Les Origines de l'Empire Ottoman"* (Paris, 1935, f 22), e kjo mund të vërtetohet ose të hetohet edhe sipas regjistrat të veprave arabe dhe persiane, të cilat i ka radhitur në veprën *"Das Werk des Azis ibnu Ardashir Astarabadi"* - *Eine Quelle zur Geschichte des Spätmittelalters in Kleinasien* heinz Helmut Giesecke (Laipzig, 1940, f. 114), sepse këto vepra mbase të hartuara në nismën e shtetit osman kryesisht bëjnë fjalë për historinë e Egjiptit dhe të Iranit.

Natyrisht, në këtë rast nuk na interesojnë burimet orientale për themelimin dhe fillimin përgjithësisht të Perandorisë Osmane, por vetëm ato të cilat flasin gjerësisht a shkurtimisht për atë betejë që shkaktoi shkatërrimin e shtetit mesjetar serb. Ato burime të vjetra orientale tek ne janë përpunuar pjesërisht dhe këtu do të flitet për këto shkarazi.

Safvet-beg Bashagiqi ka shkruar një artikull për origjinalin në osmanishte dhe përkthimin tonë nga *"Iskendernameja"* (*"Aleksandrida"*) e Ahmedit, e cila përmban tregimin më të vjetër osman për Betejën e Kosovës. Ahmedi, pas Nesimit, është shkrimtari më i madh i shek. 14, kurse epi i tij romantiko-historik për Lekën e Madh (i përfunduar në versionin e parë në vitin 1390) mbështetet në burimet persiane, mirëpo duke i kënduar Lekës së Madh, ai ofron të dhëna edhe më të gjëra për historinë e Azisë së Vogël, e në veçanti për princërit osman, duke iu qasur kështu edhe Betejës së Kosovës. Ky artikull i Bashagiqit (në "Glasnik Zemaljskog

muzeja" l. 36, 1924, f. 95-99), ka nxitur edhe historianin e njohur F. Shishiç, që t'i hedh një vështrim edhe atij burimi më të vjetër osman edhe pse tregimi për Betejën e Kosovës është në vargje ("Kontribut i ri për Betejën e Kosovës" në *Stara Hrvatska Prosveta*, nova serija, l. I, Zagreb, 1927, f. 96-97).

Dy burime të tjera osmane ndër më të vjetrat për Betejën e Kosovës janë: historia e përgjithshme e Shukrullahut me titull: "*Behxhetut - tevarih*" ("*Hijeshia e historisë*"), e cila është shkruar në gjuhën perisane rreth vitit 1459 dhe "*Tevarihi al'i Osman*" ("*Historia e Dinastisë Osmane*") e Uruxhit, të cilët flasin për ngjarjet që nga themelimi i shtetit osman deri më 1467. Si artikulli i Shukrullahut, i cili përfaqëson burimin më të vjetër në prozë nga një historian osman, po ashtu edhe tregimi i Uruxhit për Betejën e Kosovës, i cili konsiderohet burim më i vjetër në prozë në gjuhën osmane, janë të njohur për opinionin tonë të gjërë nga arikujt e mi, respektivisht në gazetën "Politika" të Beogradit.<sup>1</sup>

Mirëpo, siç shihet nga datat e lartpërmendura, tregimet e Shukrullahut dhe të Uruxhit për Betejën e Kosovës janë hartuar rreth 70 vjet pas betejës (1389), prandaj kronologjikisht mbesin mjaft prapa nga një burim tjetër oriental nga fundi i shek. 14 (dorëshkrimi i të cilit është përfunduar në vitin 800/1398 që gjendet në Aja Sofi), d.m.th. një burim i cili mund të konsiderohet bashkëkohor me Betejën e Kosovës, me fjalë të tjera, i cili sipas vjetërsisë vjen menjëherë prapa tregimit të Ahmedit, i cili, së paku, ashtu më duket mua, tek ne nuk është i njohur, e lëre më të jetë analizuar.

Ky burim oriental, sikurse u tha, është i vjetër më shumë se 30 vjet nga burimi ynë më i vjetër në të cilin tregohet Beteja e Kosovës, kjo d.t.th. jeta e despotit Stefan Llazareviqit (rreth vitit 1431) nga Konstandin Filozofi bartë titullin në gjuhën perisane "*Bazm u razm*", kurse rjedh nga Aziz ibn Ardashir Astarabadi. Sipas mendimit të M. F. Köprülüut (*Les origines...*, f. 23), ky përgjithësisht është

---

<sup>1</sup> Fragmenti origjinal i Shukrullahut për Kosovën, i cili gjindet në punimin e Theodor Seifit "*Der Abschnitt über die Osmanen in Shukrullah's persischer Universalgeschichte*", botuar në *Muttellungen zur osmanischen Geschichte* (I.II. Hanover. 1925. f.92-94), e artikulli im për atë me titullin "*Jedan persiski tekst o bici na Kosovu*", është botuar në numrin e krishtëlindjeve të "Politikës" për vitin 1933. Fragmentin e Uruxhit për Kosovën unë e kam përpunuar në numrin e krishtëlindjeve të të njëjtës gazetë për vitin 1935 me titull "*Jedan odvojeni turski prikaz kosovske bitke*"; ai artikull është përkthyer, respektivisht reprodukuar, në gjuhën frëngjishte në revistën "*L'Europe Centrale*" (Pragë, 16 shkurt 1935). Vetëm pas disa artikujve të ndryshëm për këtë lëndë dhe sigurisht nën ndikimin e tyre. Aleksej Olesnicki botoi burimet e tij turke për Betejën e Kosovës në "*Glasnik Skopskog Naučno Drustva*" (I.XIV, 1935.f.59-98). K. Grujiq në "*Hrvatska revija*" (VIII.1935, f. 502-504), më të drejtë ia pa për të madhe Olesnickit, sepse pjesa më e madhe e dokumenteve në punimin e tij, kanë qenë të botuara dhe të përkthyera para tij.

"Burimi më i rëndësishëm nga burimet që kemi për Anadollin në gjysmën e dytë të shek. 14"; ky nuk përmbledh vetëm ngjarje politike dhe ushtarake, por është i rëndësishëm edhe për topografinë historike të Anadollit, për historinë e tij kulturore dhe për etnologjinë, sikurse që e thekson me plotë të drejtë dijetari osman në parathënien e "*Bazm u Razm*" (f. 21). Në të vërtetë, detyra kryesore e kësaj vepre është të tregojë për jetën e bujshme dhe luftërat e përhershme të Sivasit ("sultanit") kadiut Burhanuddin, i cili jetoi nga viti 1345 deri më 1398, kurse ka sunduar si "sulltan" nga viti 1381 deri në vdekje (1398). Astarabadi, siç po tregon edhe emri, është me prejardhje nga një qytet i vogël por në zë, në veri të Iranit (jo larg liqenit Kaspik).<sup>2</sup> Ka studiuar dhe ka jetuar si poet i oborrit në Bagdad, por duke ikur nga sulmet e çagatajëve dhe tatarëve gjeti strehim, në vitin 1394, tek sulltani i lartëtheksuar (i cili atëherë ishte në Kajseri) dhe nga ajo kohë, pra gjatë katër viteve të fundit të jetës së sulltanit, qendroi për pakë kohë si poet oborri dhe mund të themi si historiograf zyrtar. Nga ai raport lindi kronika e njohur me titullin e lartpërmendur.

Mirëpo, jo vetëm që ajo kronikë u hartua sipas dëshirës së vetë sulltanit dhe shpesh mbi bazë të tregimeve dhe informatave të tij, por ai propozoi edhe titullin e lartpërmendur "*Bazm u razm*", që në gjuhën persiane do me thënë "*Ahengu dhe beteja (lufta)*", ose, në qoftë se dëshirojmë të imitojmë rimën e origjinalit, do me thënë "*Hareja dhe beteja*".<sup>3</sup> Kadi Burhanuddini ose, siç e quan përherë Astarabadi, sulltan Ahmedi, që edhe vetë ka qenë poet dhe i ka njohur mirë poetët persian, propozoi, siç më duket mua, këtë titull nën ndikimin e Shahnamesë së Firdusit, ku shpesh flitet për ahengjet, pirjet në ato ahengje dhe lufëtrat e disa sunduesve, e ne veçanti të atyre sasanide ku këto dy fjalë përbëjnë rimën në të parin dhe në të dytin gjysmëstrofë të shtofës respektive (bejtit).<sup>4</sup>

"*Ahengu dhe lufta*" nuk mban vetëm titullin në persishte, por edhe e tëra është e hartuar në atë gjuhë. Kur kuptojmë se kjo gjuhë ka qenë zyrtare që në kohën e selxhukëve të Azisë së Vogël, atëherë kjo nuk na befason, dhe se kjo traditë (e cila të kujton rolin e italishtes në Dalmaci edhe pas çlirimit nga venedikasit) ka zgjatur shumë kohë. Vet Astarabadi, i cili gjuhë amtare kishte persishten, potencon si arsye për këtë edhe atë që banorët e Azisë së Vogël, pra ruminjtë e duan këtë gjuhë dhe

<sup>2</sup> Për këtë më gjerësisht në: "*Enzyklopaedie des Islam dhe në Grundriss der iranischen Pfilologie*" (libri II, Štrassburg, 1896-1904, Register).

<sup>3</sup> Sipas kuptimit dhe ruajtjes së rimës, mund të përkthehet edhe "*Banketi dhe bajoneti*", sikur fjala e fundit të mos paraqiste anakronizëm për Astarabadin, respektivisht edhe për periudhën e Betejës së Kosovë (bajoneta është konstruktuar në shek. XVII).

<sup>4</sup> Sipas Gloses për Šahnamenë e Firdevsit nga Fritz Eöolfi (Berlin, 1935), f. 142, "*Bazm u razm*" në lidhje të tillë ose të njëjtë paraqitet në epos në më shumë se tetëdhjetë vende.

se kjo me të madhe përdoret si gjuhë zyrtare në administratë, komunikimin e shkresave etj. Por gjuha persiane e Astarabadit është përplot me fjalë dhe shprehje arabe, e disa pjesë në tërësi janë në gjuhën arabe. Stili i kësaj vepre është shpesh në frymën e atëhershme të shkrimit persian: Për ngjarjet dhe gjërat më të rëndomta përdorën fraza të rëndomta dhe të ngatërruara, sinonime të ndryshme, figura, fotografi paralelizma dhe të ngjashme, e krahas tyre në tekst është ndërthurur masë e madhe e citeve poetike nga shkrimtarë të ndryshëm persian dhe arab (1541 vargje), fjalë të urta arabe, e aty gjejmë edhe shumë kaside (vjersha) dhe strofa të zgjedhura arabe dhe persiane (196 strofa) edhe nga Astarabadi personalisht.<sup>5</sup>

Se "*Bazm u razm*" ka qenë një kohë të gjatë (deri në vitin 1910) e panjohur për shkenctarët dhe i pa shfrytëzuar si burim historik, kryesisht arsyeja qendron në atë se asnjë bibliotekë evropiane nuk ka asnjë dorëshkrim të kësaj vepre. Vetëm në vitin 1910 shkenctari i njohur dhe shumë i respektuar turk Halil Ed'hem<sup>6</sup> tërhoqi vërejtjen e profesionistëve në faktin se nga kjo vepër ekzistojnë katër dorëshkrime në Stamboll. Katër vjetë më vonë, në revistën e Shoqatës së historianëve turk<sup>7</sup>, Ahmed Tevhidi me titullin "*Kadi Burhanuddin Ahmed*", rezimoi (në gjuhën turke) përmbajtjen kryesore nga "*Ahengu dhe lufta*", por në një mënyrë mjaft të papërcaktuar, d.m.th. duke mos përcaktuar askund faqet e dorëshkrimit që i kishin shërbyer si bazë. Mirëpo, vepra edhe më tutje mbeti e pabotuar.

Vetëm në vitin 1928, Instituti i Turkologjisë në Stamboll e botoi në tërësi veprën "*Ahengu dhe lufta*" me një përgatitje të bukur. Parathënien e kishte shkruar drejtori i Institutit, Köprülüzade Mehmed Fuad<sup>8</sup>, kurse tekstin në persishte (pa parathënie), i cili përfshinë jo më pak se 541 faqe e përgatititi për shtyp Kilisli Rifat. Kështu, kjo vepër u bë e afërt, së paku për ata që e dinë gjuhën persiane, thënë më mire, për ata që e njohin mirë gjuhën persiane, duke pasur parasysht mënyrën e pshtjelluar të paraqitjes dhe stilin e zbukuruar. Kilisli s'ka mundur të paramendoj se lexuesit e tij turq, të cilët ende kishin pasur traditë të fortë në këtë

---

<sup>5</sup> Që "Ahengu dhe beteja" nuk përmban vargje në gjuhën turke të kadi Burhanuddin, mbase mund të sqarohet me atë që Astarabadi nuk ka ditur turqisht ose ka ditur fare pak.

<sup>6</sup> Në punimin e vet për titujt në Sivas dhe Divrixh, që e ka botuar së bashku me van Berchemin në Kajro më 1910.

<sup>7</sup> "*Tarihi-i osmani engymeni mecmuasi*" (TOEM), v.V.nr.26-32, e në numrin 25 është treguar dinastia Eretna, që më mirë të kuptohen jeta dhe kurthat e kadiut Burhanuddin.

<sup>8</sup> Në Bibliografinë e punimeve të Köprülüs nga viti 1913-1934, të cilën e ka përshtatur e botuar Sherif Hulus Sejmani (Stamboll, 1935, f. 14 nën numrin 225; kjo "*Parathënie*" është citua jo sipas titullit faktik, por sipas përmbajtjes: "*Aziz bin Erdeshir Esterabadi ve eseri hakkinda*". Nga kjo shihet shprehja turke e mbiemrit të autorit dhe qytetit të tij të lindjes; në të njëjtin vend është edhe titulli i veprës dhënë në gjuhën turke, kjo d.m.th. "*Bezm ve Rezm*".

drejtim, dhe në masë të mirë shërbeheshin me gjuhën e Firdusit dhe Hafizit, respektivisht me stilin bombastikë perisan të Udbiut, Gjuvejniut dhe të historianëve të tjerë prandaj në fund të botimit shkroi në turqisht përmbajtjen e shkrutër të ngjarjeve prej 38 faqesh të atyre ngjarjeve më të rëndësishme për të cilat bënë fjalë origjinali në persishte. Natyrisht, mbi bazë të kësaj rezymeje, me fjalë të tjera, vetëm me njohjen e gjuhës turke, askush nuk ka mundur të vërtetojë me siguri se çka thuhet për një ngjarje të caktuar në këtë vepër historike aq të rëndësishme për atë kohë dhe ato vende.

Menjëherë, këtu duhet përmendur se Giesecke në punimin e tij të theksuar më parë, krahas hyrjes së gjerë, shqyrtimeve kritike dhe të dhënave të ndryshme por të dobishme, ka dhënë përmbajtje të gjerë të ngjarjeve të rëndësishme në veprën "*Ahengu dhe lufta*", mirëpo edhe kjo nuk mund të zëvendësojë origjinalin, sidomos, po qëse kemi për qëllim që për një ngjarje a person t'i njohim të gjitha hollësitë që na i ofron Astarabadi<sup>9</sup>.

Siç e dimë, Astarabadi veprën e vetë e quajti "*Bazm u razm*", mirëpo turqit shpesh kanë parasysh përmbajtjen e saj të vërtetë, prandaj e quajnë "*Historia e Kadiut Burhanuddin*"<sup>10</sup>, ose "*Tiparet e Kadiut Burhanuddin*", ose, në periudhat më të hershme dhe më saktësisht, "*Historia e Kadiut Burhanuddin nga Sivasi*".<sup>11</sup> Dhe, vërtetë, siç u tha shkurtimisht, ajo është tregim i jetës, luftërave dhe kurthave të princit ("sulltanit") të njohur Ahmed Burhanuddinit nga Sivasi, mbase të njohur si poet turk me emrin Kadi Burhanuddin.<sup>12</sup>

<sup>9</sup> Në dhënien e përmbajtjes nganjëherë Giesecke - edhe pse ndryshe është pritur - është më i shkurtër se Kilisliu, si p. sh. në f. 20, 47-52 të origjinalit, ose në f.21=61 të tekstit në persishte. Mirëpo, kjo fare nuk zvogëlon dobinë nga punimi i tij; padyshim, ai vendet e tilla i ka konsideruar më pak të rëndësishme, andaj më shkurt i ka paraqitur se sa botuesi turk. Momenti subjektiv në këso rastësh luan rol të konsiderueshëm.

<sup>10</sup> Halil Edhemi, "*Dyvel-i islamije*" (Stamboll, 1927, f. 388), mbase e përmend edhe titullin e vërtetë.

<sup>11</sup> Tek Haxhi Halifeja nën numrin 2273 (sipas Babingerit, *Die Geschichtsschreiber der Osman und ihre Werke*, Laipciq, 1927, f.5).

<sup>12</sup> P. Melioranski që në vitin 1895 i përktheu dhe i botoi 20 rubaira dhe 12 tujuga (Boctocni zametki, f. 131 dhe në vazhdim; sipas Enciklopedis Islame Burhan al- Din). E. J. Ė. Gibb vazhdon në historinë e vet "*History of Ottoman Poetry*", e ka përshkruar jetën e Burhanuddinit dhe veprimtarinë poetike (libri I. f. 204-213, duke ofruar në përkthim 6 gazela të tij, 8 rubaira dhe 9 tujuga (në f.214-224), me origjinalin në gj. turke ( I. VI, f. 16-20). F. F. Godselli ka botuar në vitin 1922 në Stamboll "*Divanin*" e Burhanuddinit. "*Tyrk edebijati numunleri*" nga Hivzi Teufiku dhe të tjerëve, ofron gazelat, rubairat dhe tujugat e kadiut (L. I, Stamboll 1927, f. 94-101). Sadettin Nyzhet, duke shkruar për kadiun Burhanuddin si poet të letërsisë azerbejxhane, në librin e tij "*Tanzimata kadar Muhtasar*

Astarabadi nuk ka pasur punë të lehtë. Është dashur të përshkruaj në dritë të dobishme jetën e një poeti-jurist me renome, poetit turk të talentuar dhe luftën e tij për pushtet, me ç'rast ai nuk kishte kursyer as vjehrrin, djalin e motrës dhe të tjerët, të cilët e pengonin në rrugën drejt pushtetit. Pasi përforëcoi pushtetin e vetë, duhej treguar betejat e tij të përhershme, dilemat dhe luftërat. Ky njeri ambicioz, agresiv, i ashpër dhe i trazuar, që më parë kishte qenë kadi (duke e trashëguar këtë titull nga i ati - kadi që në moshën 21 vjeç), pastaj vezir (1378) i Ali Beg Eretnit, sunduesit të Sivasit, pastaj mëkëmbës (1380) i djalit të mitur të Ali Beg Eretnit dhe pastaj duke i vrarë Kilig Arslanin dhe Kejhusevin, uzurpoi pushtetin, e pas fitores mbi Sadgeldiun (nga fundi 1381) "sulltanit të Sivasit", i cili kishte luftuar edhe kundër karamanidëve të fuqishëm, si dhe kundër sulltanit osmanli Bajazid Jëlldërimit, në këtë histori është treguar shumë më simpatik dhe më i dobishëm nga ana e historiografit të tij zyrtar dhe poetit të oborrit, i cili ka ditur të vlerësoj mbrojtjen dhe donatimin ndaj vetes, se sa, çfarë dhe si do të ishte e shkruar nga një historian objektiv dhe i pamvarur, i cili nuk do t'i kishte pasur ato obligime dhe kujdesin për sunduesin e vet.

Gjithsesi, s'ka dyshim për atë, që treguesit e rinj objektiv të jetës së Burhanud-dinit, sado që të jenë të përmbajtur (së paku disa) s'mund të fshehin vrazhdësinë e tij, pjesëmarrjen në vrasje, e bile në një seri vrasjesh të drejtpërdrejta.<sup>13</sup> Thënë

---

*Türk Edebiyatı Tarihi ve nymyneri* (Stamboll 1931, f. 84), tregon (në faqën 102) vetë një gazele të tij dhe një tujug. Është interesant se "*Kamusu-l alam*" i Sh. Sami-beut (libri II, Stamboll 1889, f. 1301 Burhaniddinin), aspak nuk e përmend se ai ka qenë poet. Poezitë e Burhanuddinit janë vetëm për nga gjuha turqisht, sepse frymojnë persisht.

<sup>13</sup> Cf. Huart në "Enzyklopedi des Islam" (1912), s.v. Burhan ad-Din (Kadi). Ahmed Tevhid në TOEM, viti V (1914), f. 475-476 (e gjykon Burhanuddinin shumë ashpër. E. de Zambaur, "*Manuel de Genealogie et de Chronologie pour l'Histoire de l'Islam*", Hanover, 1927 f.196, nr.151 (në hartën Asie Mineure environ 730 de l'hegire, është shenjuar edhe vendi i pushtetit të Burhanuddinit). Halil Edhem, "*Dyvel-i ilamijje*", Stamboll, 1927, ia kushton gjithë kapitullin (f.387-8) këtij kadiu, duke theksuar, përveç të tjerave, edhe pjesëmarrjen e tij në vrasjen e Mehmed bej Eretnes. Me gjithë këtë, "Tarihun" që e ka botua Shoqata e Historianëve turk (Stamboll, 1933, libri II, f. 277) e absorbon Burhanuddinin (siç ekziston aty) vetëm në pesë rreshta. Nga historitë me të njohura të Perandorisë Osmane asnjëra nuk i thekson veprimet e këqija të Burhanuddinit, por shkathtësitë e tij të jashtëzakonshme shtetërore dhe shkencore (J. von Hammer-Purgstall, *Geschichte des osmanischen Reiches*, 2 Auflage, I, I pesth 1840 f. 189; J. E. Zinkeisen, *Geschichte des Osmanischen Reiches in Europa*, I, I. Hamburg, 1840, f.351-2), Hammeri, sipas traditës së vet e përkthen edhe emrin e kadiut si "*Richter Glaubensbeëis*". Zinkeiseni, duke u bazuar në përkthimin italian, Sadudinin e thekson se Burhanuddinin ka mundur në luftë t'i dërgojë 20 deri në 30 mijë kalorës. N. Jorga, "*Geschichte des Osmanischen Reiches*", I, I. Gotha 1908, f. 308-9) fare pak di për të, por pohon se është quajtur "*Tekkiur ose mbret*" dhe "*gazi ose triumfues*", dhe se ai në persishte është quajtur

shkurt, ky është një nga ata gjykatës që duhet të gjykohet dhe për këtë shkak lindi fjalia e urtë arabe (sipas disave hadith i Pejgamberit), por jo mirë i garantuar, mungon në koleksionet Buhari dhe Muslim:<sup>14</sup> "Një kadi në Xhennet dhe dy në Xhehennem".

Nga kjo që thamë, njëkohësisht mund të shihet se sa punë të lehtë ka pasur Konstandtin Filozofi duke përshkruar jetën dhe veprën e sundimtarit të tij, despotit Stefan Llazar (1389-1427), sesa Astarabadi, i cili me doemos është dashur t'i zbukuroj, t'i lejoj dhe t'i heshtë shumë momente nga jeta e sundimtarit të tij impulsiv.<sup>15</sup>

"*Ahengu dhe lufta*", e cila pranë qëllimit kryesor, përshkrimit të jetës dhe të veprës së sulltanit të Sivasit, përshkruan edhe rënien (fundin) e dinastisë Eretne (1335 - 1365) dhe përgjithësisht paraqet kontribut të rëndësishëm për njohjen e principatave të vogla në Anadoll, para paraqitjes së Timurlengut e përfunduar në vitin 800 hixhri, d.m.th. në vitin 1397-98.<sup>16</sup> Këtë vit, edhe pse disa muaj më vonë,

---

Burhanuddin. Ky pohimi i fundit është jo i saktë, sepse emri Burhaniddin është arab, respektivisht titull nderi që ka kuptim "*argument i fesë*", ashtu siç e ka përkthyer Hammeri. Në të vërtetë, vetëm pjesa e parë e kësaj fjale të përbërë (status contractus), pra fjala "*burhan*" mund deri diku të quhet e "*dritë, ndriçim*" e pjesa tjetër "*din*" është (në këtë kuptim) persisht. Nga historianët e vjetër, Saduddini së pari thekson se Burhanuddini (siç e quan ai) disponon me 20 deri 30 mijë "kalorës gjakpirës" ("*Tagut-tevarihi*", I. I. Stamboll 1927 f. 133), e pastaj, duke folur për ulematë e njohur gjatë pushtetit të Muratit I, për të thotë se "është i njohur me zhdërvjelltësinë e vet" (!), se është autor i "Telvih"-ut, por nuk harron të thotë se e ka vrarë babëgjyshin (e njëjta vepër, II, 410).

<sup>14</sup> Gjindet vetëm në koleksionet (me autoritet më të vogël) të Abu Daudit (Kitabi 23, bab 2), at-Termidhiu (13,1) dhe Ibni Maxhe (13,3); krahaso A. J. Ėsensick, *A Hendbook of Early Muhammedan Tradition*, Leiden 1927, f.119 dhe përkthimin arab të kësaj vepre nga Muhammed Fuadi Abdul-baki, Kairo 1352/1933, f. 386.

<sup>15</sup> Nga ana tjetër, bien në sy disa ngjashmëri në mes të Astarabadit dhe Kostantin Filozofit: të dy janë mjaft të arsimuar; të dy largohen nga vendlindjet e tyre (Bagdadi respektivisht Bullgaria); të dy jetojnë në oborrin e një sundimtari, i cili është i arsimuar dhe letrar; të dy përshkruajnë jetën dhe veprën e atij sundimtari; edhe njëri edhe tjetri biografe ofrojnë mjaft të dhëna historike; të dy i përshkruajnë ngjarjet, - pak a shumë - sipas tregimeve të sundimtarëve të tyre; të dy kanë jetuar për afërsisht në të njëjtë kohë, dhe, çka është kryesorja, të dy raportojnë për Betejën e Kosovës. Natyrisht, krahas të gjitha këtyre, ka pak a shumë dallime në mes këtyre dy analistëve: Konstatini fletë edhe për vdekjen e sundimtarit të vet dhe ekspozon mjaftë ngjarje pas saj, që te Astarabadi nuk ndodhë, etj. Më gjerësisht për Konstantinin shih "*Pasqyra e letersisë serbe*" nga Pavel Popoviq (botimi i 3 Beograd 1919, f. 38-40) dhe Parathënia që e ka shkruar i njëjti shkenctar për Biografitë e vjetra serbe të shek. XV dhe XVI (Camblak, Konstantin, Pajisije) në botim të Serpske knjizevne zadruge (Beograd, 1936, f. XXXVII-LIII).

<sup>16</sup> Që H.H. Schaefer në Permendorën e Giesit (Festschrift Friedrich Giese, Berlin 1941, f. 26), thotë se veprën Astarabadi e ka përfunduar në vitin 1396, kjo është, siç më duket mua,

pra me siguri në vitin 1398<sup>17</sup>, u vra edhe sulltan Ahmedi, inicues dhe kryetrim i këtij libri dhe kjo vrasje u bë në mënyrë shumë mizore: në konfliktin në Karabel (ngushticë afër Divrigiut në rrethinën e Diarbakirit) e vrau Kara Osman Begu<sup>18</sup>, i cili përshkak të sjelljes gjakpërëse u quajt Kara Jylyk, që d.m.th. "Ushujza e zezë"<sup>19</sup>. Ai në të vërtetë, ishte lider i fisit turkmen Akojunllu dhe më vonë (1403?) themelues i dinastisë "Dashi i Bardhë"<sup>20</sup>.

Për atë përfundim famëkeqë të sundimitarit të Sivasit flasin shkrimtarë të ndryshëm, por pa të dhëna më të përafërta. Mirëpo, raport i gjërë dhe i tmershëm për të gjendet në udhëpërshkrimin e njohur të Hans Schiltbergerit nga Minheni, i cili, siç është e ditur u zu rob pas fitores së Bajazitit mbi mbretin hungarez (dhe më vonë mbreti i Gjermanisë) Sigumundin në betejën tek Nikopoja, pastaj me lutjen e djalit të sulltanit, përshkak të moshës së re (16 vjeç) u kërkuar të kursehet nga vdekja e sigurt, të cilës robërit e tjerë nuk mundën t'i iknin, dhe u vendos që të qëndronte pranë sulltanit dhe, së bashku me sulltanin, në betejën e Ankarasë (1402)

---

bartje e gabimit teknik, sepse viti hixhri 800 nuk i përgjigjet vitit tonë 1396, por viteve 1397 dhe 1398.

<sup>17</sup> H. Edhem. *Dyvel-I islamije*, f. 387, e vendos vrasjen e sultan Ahmedit në fund të viti 800 ose në fillim të 801, e kjo edhe më shumë fletë për vitin 1398.

<sup>18</sup> Saduddini (I,134), duke folur për fushatën e Bajazitit në Tokat dhe Sivas, thotë se sulltan Burhanuddini u largua në malet e Harbutit afër Diarbakirit, por aty hasi në Kara Osmanin, të quajtur Karar Ilyk, i cili e vrau. Më vonë, në librin e II (f.410) ky historian turk fletë të njëjtën, pra për vdekjen e Burhanuddinit, vetëm se e precizon se ajo ka ndodhur në fund të vitit 800 sipas hixhrit. Halil Edhemi (f.387) nuk e thotë në mënyrë të prerë se Kara Osmani e vrau sulltanin, por vetëm se është vrarë në betejën tek Kara-Bela. Siç do ta shohim më vonë. Schiltbergeri tregon se Burhanuddini me robërit e tjerë u dërgua në Sivas dhe aty u vra.

<sup>19</sup> Hammeri (GOR, I, 189) e shkruan Kara Juluk dhe e ka përkthyer "der schëarze Blutege", por Aug Miller (*Der Islam im Morgen-und Abendland*, I. II, Berlin 1887, f. 302) ka theksuar se "ushujza" në turqishte thuhet sylyk, e jo juluk. E. G. Broëne (*A History of Persian Literature under Tartar Dominion, Cembridge 1902, f. 404*) e shkruan këtë nofkë Kara iluk dhe e përkthen si "Black Leech", pra sikur Hammeri. Sipas mendimit tim, është e mundshme që ushujza në dialketin lokal të quhet iluk, por këtë duhet verifikuar. H. Edhem (f. 407) thekson katër forma të ndryshme të kësaj fjale.

<sup>20</sup> Siç thotë M. F. Köprülü (Les Origines... f.52), Tyrkmeni Akkujunlu dhe Karakojunlu erdhen kah fundi i shek.XIII masivikisht nga Azia Qendrore në Anadollin Lindor dhe në Azarbejxhan. Historinë e këtyre dy fiseve, respektivisht dinastive, me pasqyrë gjenealogjike e ofron H. Edhem, f. 404-412 Punimin e Ismail Hakki Uzunçarshiliut "*Anadolu Beylikleri ve akkoyunlu karakoyunlu devletleri*" (Ankara, 1937) deri me tani nuk e kam pasur në dorë. Bie në sy se "*Historical and commercial Atlas of China*" nga A. Herrmani (Cembridge, Massaschusetts, 1935), i cili është i dobishëm për studime turkologjike, nuk e ka në hartat e tij asnjërën nga këto dy dinasti që kanë sunduar rreth 130 vjet:

u zu rob nga fituesi Timurlengu, e më pastaj qëndroi gjatë në shërbim të tij dhe më në fund (në vitin 1427) u kthye në Gjermani<sup>21</sup>.

Ky gjerman flet për vdekjen e Burhanuddinit dhe detaje të tilla, sa që njeriut i rënqethët lëkura: Kur Kara Osmani e robëroi e dërgoi atë para sundimtarit të vet, e ky së bashku me robërit e tjerë e dërgoi në Sivas dhe pas bisedimeve të pasuksesshme më banorët e atij qyteti që ai qytet të dorëzohej, i urdhëroi njerëzit e vet ta therin para syve të tij dhe ta coptonin në katër pjesë dhe pastaj secila pjesë të hidhej në hu dhe të ekspozohej për banorët e qytetit, ndërsa kokën t'ia vendosnin në skarë.<sup>22</sup>

Pasi Astarabdi e kishte përfunduar veprën e tij disa muaj para vrasjes së sulltanit, ai, natyrisht nuk flet për përfundimin tragjik të donatorit të vet, por edhe neve kjo tani nuk na intereson. Për ne është më rëndësi se "*Ahengu dhe lufta*" e përfundon tregimin e ngjarjeve historike në vitin 1397. Me fjalë të tjera, përfshin ose së paku përmend luftimet e sulltan Ahmedit edhe me osmanlinjtë, më saktësisht me Muradin I dhe Bajazidin I, e kjo na jep shkas që të kërkojmë siç do të thuhej në stilin e astarabadit në këtë mori frazash dhe ndërthurjesh ndonjë grimcë lajmi për Betejen e Kosovës. Dhe, vërtet siç thekson në vazhdim Astarabadi, zhytja në këto thellësi të pamatura ka ofruar ndonjë thesar të vogël të të vërtetës për këtë betejë.

E tani të shiqojmë nga afër ato vende, të cilat tregojnë, ose së paku përmendin atë që për ne është më rëndësi dhe me interes. Ja ato vende, natyrisht në radhë kronologjike.

Pasi Astarabadi në imtësi ka treguar se si Burhanuddini në këtë a në atë mënyrë u lirua nga rivalet e vet, respektivisht pretenduesit për pushtet, kalon në përshkrimin e asaj se çfarë ka bërë ai sulltan i Sivasit<sup>23</sup>, thënë ndryshe, si sundimtar pa përkufizime i Anadollit Lindor. Në atë radhitje, autori i "*Ahengut dhe lufta*",

---

<sup>21</sup> H. Schiltberger, Reisebuch, botim i V. Langmantel, Tübingen 1885, f. 16 dhe në vazhdim (citoj sipas Giesecke-s, sepse nuk arrita ta kem atë botim). Broëne në Historinë e tij të letërsisë persiane nën dominimin tatar (1265-1502), citon (f. 404) përkthimin anglez të librit të Schiltbergerit (Bondage and Travels, botim i Hakluyt Society-s, 1879) dhe thekson se në të (keru IX) sulltani i Sivasit quhet "Eurchanadin".

<sup>22</sup> Sipas Giesecke-s, f. 127.

<sup>23</sup> Siç pohon Sh. Sami beu, Sivasi në kohë të selxhukëve ka pasur 120.000 banorë, e medresetë e tij kanë qenë një lloj universiteti, së paku për atë kohë (*Qamusu-l alam*, I.IV, Stamboll 1311/1894, f.2794). Ai qytet (më heret Sebasteia respektivisht Sebaste) ka qenë edhe më vonë qendër zejtare dhe tregtare në të cilën punëtoritë e veta i kanë pasur tregtarë nga Gjenova. Për rëndësinë e Sivasit në shek. XIII më gjërë fletë Köprülü në veprën e përmendur "*Les Origines...*", f. 67 dhe 72-73.

tregon edhe për ngjarjet që kishin ndodhur pas muajit të ramazanit të vitit 790, d.m.th. pas tetorit të vitit 1388, ku, në mes të tjerash, thekson ("*Bazm u.razm*", f. 381, rreshtat 15-18) se disa njerëz kishin ardhur nga Amasja dhe kishin lajmëruar sulltanin se si pranë atij qyteti ekziston një kështjellë e rrënuar, të cilën duhet rindërtuar, se në të kundërtën Amasja nuk do të mund t'u bëjë ballë sulmeve armike dhe medoemos do të dorëzohej.<sup>24</sup> Pas disa ditësh, atje shkoi sulltan Ahmedi dhe urdhëroi që kështjella e rrënuar të rindërtohej. Me këtë rast Astarabadi paraqet diçka që ka të bëjë me fushatën luftarake të sulltan Muradit në Kosovë edhe pse në mënyrë të theksuar nuk përmendet as emri i sulltanit osman e as vendi i vrasjes së tij.

Në atë kohë tregon vepra "*Ahengu dhe lufta*" derisa ende ishte në Amasja, i erdhen sulltan Ahmedit princat mongolë<sup>25</sup> dhe e lajmëruan se "Osmanliu" ("në të vërtetë biri i Osmanit" mendohet në sulltan Muradin I)<sup>26</sup> ishte nisur kundër pabesimtarëve dhe thotë se është e tepërt dhe e panevojshme të shqyrtohet dhe sqarohet se çfarë armiqësie dhe rivaliteti ndien ai (Muradi) ndaj sulltan Ahmedit, duke theksuar përveç të tjerash, shembullin e vullnetit të keq dhe të urrejtjes, dhe atë se si i është

---

<sup>24</sup> Amasia, qytet në verilindje të Sivasis.

<sup>25</sup> Grupe të shumta turko-mongole erdhën (përmes Kaukazit ose nga Rusia jugore me anë të detit) në Anadoll dhe aty u vendosen, e pasi kjo ndodhi në periudhën e ilhanëve mongolë (1265-1337), këto fise në burimet historike njihen si mongolë, edhe pse një pjesë e madhe nuk ishin mongolë, por turq (Köprülü. "*Les Origines...*", f.53). Në lidhje me përdorimin e gjërë të fjalës "mongol" (në original mogul, pa shkronjën "n"; shprehjet "moguli i madh" dhe "perandoria mogule" po ashtu pa "n") . bie në sy se edhe H. Edhem në veprën e tij të shkëlqyeshme "*Shtetet Islame*", në kreun XI që titullin Mongolët ("Mogolar") dhe fillon me Xhingis kanin, ka shkruar, përveç të tjerave, edhe për kanët e çagatajve dhe eretnitëve, e bile edhe për kadiun Burhanuddin, i cili trashëgoi (uzurpoi) provincat e tyre. Ilhan (princ fisnor) është titull që edhe hani i madh Kubilai (Kubla-khan te shkrimtari anglez Coleridge) ia ka dhënë këtë titull në vitin 1263 Hulagut, ngase sundoi i pamvarur me Persinë dhe me vendet në perëndim të Oksusit (Amu Darja) (Aug. Myler, *Der Islam im Morgen und Abendland*, I, 237). Në fillim, ilhanët nominalisht ishin mekëmbës të hanëve të medhenj të Kinës, por me kalimin e kohës e menjanuan këtë nënshtrim formal feudal. Siç është thënë qartë në Atlasin e Kinës të permenduri më lartë (harta 50: Asia under the Mongols, 1290 A. D.) pjesa më e madhe e Azisë së Vogel (lindja) ra nën sundimin e ilhanëve që në vitin 1308.

<sup>26</sup> Me "puser-i Osman ( pers. puser është putron në Sanskrit edhe lat. puer d.m.th. djal, fëmi) Astarabadi këtu tregon për Muratin I, por në vendet e tjera ( p.sh. në f.388), pa dyshim fjala është për birin e tij Bajazitin. Poashtu njejtë tregon edhe biografi i njohut i Timurlengut, Ibni Arabshah, vetëm arabisht, pasi tërë biografia është në arabisht ( E. G. Broëne, vep. e cit. f. 198).

kundërvu emiri Haxhi Sadgëlldiu<sup>27</sup> dhe se si ky i fundit duke vendosur kontakte me sirianët (me Damaskun), që i kishte nxitur për sulm kundër Sivasit në një anë dhe sulltan Barkukut në anën tjetër dokumentuan dhe e binden sulltan Ahmedin për atë se tani është momenti i përshtatshëm që me ushtri ta sulmojnë vendin e tij (të Muradit) dhe ta robërojnë, ta plaçkisin dhe ta shkatërrojnë. Mbase ky propozim, vazhdon Astarabadi dukej i drejtë nga pikëpamja oportune e ndonjë shtetari a pushtuesi, megjithatë, sulltan Ahmedi kishte mendim tjetër. Nga njëra anë "osmanliu"<sup>28</sup>, "i cili ishte një mongolëz i rëndomtë"<sup>29</sup>, pa afinitete shkencore e pa kurrfarë urtie"<sup>30</sup> ka shkuar në luftë kundër pabesimtarëve (në f. 382, rreshtat 3-4) dhe është i angazhuar me atë që t'i nënshtrojnë dhe t'i shkatërrojnë, e ai (sulltan Ahmedi), i cili është i drejtë dhe human dhe i çili e dinte se sipas fesë ç'është e drejtë, e lejuar dhe e ndaluar, pranë shpirtëbardhësisë së tij, urtisë dhe diturisë që në krye të myslimanëve të sulmojë vendin e tij kjo, pranë përfitimive materiale dhe përparësive për një fushatë të tillë, do të thotë të ndihmohet dobësimin (fq. 383) e fesë së vërtetë dhe forcimin e pafesë. Nga ana tjetër sulltani poet e konsideronte të pandershme dhe poshtërësi ta sulmojë armikun në kohën kur ai ishte jashtë vendit të vetë, kurse territori i tij pa ushtri. Nga këto dy arsye sulltani i Sivasit nuk u pajtua me dëshirën e princërve mongolë, të cilët ishin dhënë pas plaçkitjes së myslimanëve dhe shkreterimit të vendit të tyre (në këtë rast të Muradit) andaj, nga Amasia kthehet prapa në Sivas<sup>31</sup>.

<sup>27</sup> Krahas Kilig Arslanit konkurrent kryesor i Burhanuddinit në luftën për pushtet, të cilin ky e mundi (1381) në betejën në të cilën Shadgeldi kishte pasur ushtrinë prej katër mijë ushtarëve ("Bazm u razm", f.249).

<sup>28</sup> Se "puscer-i osman" nuk mundet bukalisht të kuptohet si "bir i Osmanit" por vetëm si trashigimtar i tij, si anëtar i dinastisë së tij, është e mjaftueshme të përkujtojmë se Murati I është bir i Orhanit e jo Osmanit.

<sup>29</sup> Që Astarabadi e quan këtu Muratin "mongol të rëndomt", ai këtë e bënë, natyrisht nga nënçmimi dhe urrejtja, e për këtë i përshtatet emërtimi i rëndomt i turqëve dhe turkmenëve si mongol, për se folem pak më parë. Mbase edhe tek ne për Muratin është thënë se ka qenë analfabet, kinse edhe marrëveshjen me dubrovnikasit (1365) e ka nënshkruar në atë mënyrë që shuplakën e ka bërë me ngjyrë të zezë dhe e ka vendosur në marrëveshje; shih. Dr. Lujo: Princi Vojnoviq, *Dubrovnik i osmansko carstvo*, Beograd 1898, f. 21. Të njëjtin pohim e gjejmë edhe në *Historija turske carevine*, nga Stanley Lane-Poole, në përkthim të Q. Mijatoviqit, Nish 1890, f. 203.

<sup>30</sup> Për atë që mendon Kilisli Rifati se fjala është këtu - مغول - mogol (kështu është vokalizuar edhe në dorëshkrimin e "*Betejës dhe Ahengut*" në Aja Sofi) duhet lexuar "*migval*" dhe se kjo do të thotë (se Murati) është vetëm "*shpatar i rëndomt*", kjo së tepërmi është tkurrë siç shihet nga vet konteksti. Mbase edhe Kilisliu nuk është përpjekur aq shumë për një lexim të tillë.

<sup>31</sup> Ky fragment na shtynë në përfundimin se te këta "princa mongol" dëshira për luftëra dhe plaçkitje është shumë më e forte se sa nga ndonjë solidaritet islam. Në të vërtetë, siç duket.

Kjo është përmbajtja e vërtetë e asaj për se fletë Astarabai në këtë tregim me plotë fraza zbukuruese, figura retorike dhe zbukurime të tjera stilistike, të cilat për historianët paraqesin një balast të panevojshëm. ("*Bazm u razm*", f. 381, rreshti 19 deri te f. 383 përfundimisht me rreshtin 4).

Nga shkaku i cili menjëherë do të jetë i qartë do të potencojmë se si Ahmed Tevhidi i përmendur më lartë (TOM, nr. 30, f. 348) ka bërë rezymen (në turqishte) nga "*Ahengu dhe lufta*": Princat mongolë të cilët u njoftuan se sulltani shehid Murad Hudavendigjari<sup>32</sup> ka shkuar në Betejën e Kosovës, andaj me këtë rast kishin ardhur te sulltan Burhanuddin Ahmed. Nga ky ata kërkuar lejen për të plaçkitur krahinat osmane, por ai këtë e kundërshtoi, pasi këtë kërkesë të tyre nuk mundi ta harmonizojë me drejtësinë dhe humanitetin. Nga aty sulltani u kthye në Sivas.

Pra, siç shihet Ahmed Tevhidi menjëherë në tregimin e vet ka përdorur, më saktësisht ka shtuar edhe fjalët Murad Hundavendigjar dhe Kosovë, që në esencë është e saktë<sup>33</sup> dhe për shumicën e lexuesve e qartë dhe e kuptueshme, mirëpo siç shihet nga ekspozimi i përmbajtjes sime (në të vërtetë përkthimi pa floskulat stilistike) ato fjalë nuk ekzistojnë në origjinalin persisht të "*Ahengu në luftë*".

Pas paraqitjes së propozimit të princërve mongolë për sulm kundër krahinave të sulltan Muradit, respektivisht pas kundërshtimit të atij propozimi nga ana e sulltanit të Sivasit, Astarabadi kalon menjëherë në ngjarjet të cilat kishin ndodhur në pranverën e ardhshme të vitit 1389. Me këtë rast "*Bazm u razm*", (f.383, rreshti 5) ekspozon se si sulltan Ahmedi ishte nisur për në Erzinxhan kundër emirit Mutah Hartanit, dhe sesi të dytë nën kushte të caktuara u morën vesh dhe bënë paqë me kusht që emiri në rast nevojë t'i ofrojë ndihmë ushtarake sulltanit. Në ato ditë, derisa sulltani gjendej në Erzinxhan vazhdon më tutje Astarabadi (f. 383, ne mes) ai e kishte parë ëndërr pejgamberin Muhammed a. s., i cili i kishte ardhur me një

---

fjala është për udhëheqësit e nomadëve turkmenë me një islamizim shumë sipërfaqësor. Siç thekson qartë Köprülü ("*Les origins...*", f. 117). Islami vetëm tek banorët e qyteteve kishte lëshuar rrënjë të forta. Në qoftë se fjala do t'ishite për mongolët e vërtetë ose fiset nga viset e tyre, te nomadët e tyre ndikimi islam ishte edhe më i dobët. Kjo është e kuptueshme kur e dijmë se hani mongolëz Gazan me 10.000 mongolë pranoi Islamit që në vitin 1295 ( E.G. Broëne. vep. e cit. f.40).

<sup>32</sup> "Hudavandgar" d.m.th. në persishtë së pari "krijues" i gjithësisë e pastaj "monark suveren" (Steingass, Persian-English Dictionary), mirëpo turqit që këtë fjalë e shqiptojnë "hudavendigar" e përdorin atë si titull për Muratin e I. Artikulli në Enciklopedija islam nuk e përmend se ky titull i jepet edhe Bajazitit të I (p.sh. te Shukrullahu në "*Mitteilungen zur osmanischen Geschichte*", I.II. f. 94 dhe 106 të tekstit në persisht).

<sup>33</sup> Unë them se "në esencë është i saktë", sepse kronologjikisht nuk është tërësisht saktë, pasi Murati në vitin vijues u nis për Kosovë.

veshjeje dervishi të tarikatis Ahmedi<sup>34</sup> dhe kur sulltan ahmedi i tregoi nderimet e detyrueshme dhe e puthi në dorë dhe në këmbë, Pejgamberi i foli sulltanit. Përveç të tjerash, i foli edhe për sulltan Barkukun<sup>35</sup> dhe për sulltan Murad Begun (d.m.th. për sulltan Muradin I), por mjaft pa përcaktueshëm duke i thënë: "Ai është i bukur, e edhe unë jam i bukur". Kur këtë e dëgjoi sulltan Ahmedi ndien paafësi dhe dhëmbje, andaj sërish i përlut Muhammedit a. s. para këmbëve dhe i thotë se ai (Muhammedi a. s.) është burim dhe rrjedhë e bukurisë absolute<sup>36</sup>.

Pas kësaj Astarabadi tregon për fatin e të dy sundimtarëve që pejgamberi a. s. në ëndërr i kishte treguar. Në përkthimin tonë thotë: "Atë ditë Murad begu u nis në luftë kundër pabesimtarëve dhe vritet atje si shehid. Mirëpo, disa njerëz me këmbëngulje pohojnë se biri i tij, gjatë betejës i urdhëroi disa shërbetorë (zyrtarë) që ta vrasin<sup>37</sup>. Cila është e vërteta e di vetëm Allahu<sup>38</sup>.

<sup>34</sup> Ky tarikat i dervishëve u shtri në Anadoll nga shek. XIII, e në shek. XIV kishte teqe të ndryshme në atë krahinë, pra edhe në Sivas. Në të vërtetë, ai ishte tarikati Rifai, por Ibni Bettuta, udhëtar i njohur arab nga shek. XIV, në udhëpërshkrimin e tij e quan tariqati ahmedijje (Keresi Csoma-Archivum, libri II, f.349). Siç thotë Köprülü në ("Les Origines...", f.115), ahmeditë kanë pasur shumicën e pasuesve në mesin e qytetarëve të varfër, e disa rite të tyre (vallëzimi, gëlltitja e zjarrit, futja në zjarr, lojërat me gjarpërinj etj.) rrjedhin nga shamanët (shih nga i njëjti shkrimtar në "*Influence du chamanisme turco-mongol sur les ordres mystiques musulmans*, Stamboll 1929, f. 12-13). Artikulli I L. Massingnonit për tarikatat në Islam (Enciklopedia islam. f. tarikatat), jep të dhëna të tjera për tarikatat rifai dhe ahmedi (i themeluar në shek. XIII). përveç të tjerash thekson edhe se rifai ende ka e ahmedit janë zhdukur.

<sup>35</sup> Barkuk, sulltan i Egjiptit me prejardhje çerkeze, ka sunduar dy here, dhe atë nga viti 1382 deri në 1389 dhe nga viti 1390 deri në 1399. Pas mundjes së ushtrisë së tij në betejën me mëkëmbësin Jelbogaj ( 1389), ai u rrëzua nga froni, e në vend të tij u ckatua Hagi II , të cilin Barkuku e largoi nga froni. Por pas disa muajsh Barkuku sërish mori pushtetin dhe sundoi edhe nëntë vjet, deri në vdekje (1399).

<sup>36</sup> Sipas mistikëve të mendimit të muslimanit Ibni Arabi ( shek. XIII) dhe al-Giliut (shek. XIV), shkalla më e lartë të cilën teozofi mund ta arrijë, është ai njeri "i cili ka realizuar unitetin e vet thelbësor me Zotin". Njeriu i tillë i ka në masë të madhe atributet e Zotit, d.m.th. atributet esenciale të bukurisë (xhamal), madhësisë (xhalal) dhe të përkryeshmërisë (kamal) dhe këto e bëjnë "njeriun e përkryer", e i tillë në rend të parë është Muhammedi. *Enciklopedia Islama* f. Abd al-Karim...al-Gjili dhe al-Insan al-kamil.

<sup>37</sup> Siç është e ditur, rëndom merret se Bajaziti, posa vdiq Murati në betejë, e vrau vëllan Jakubin. Vet turqit theksojnë se edhe Murati edhe djali i tij Bajaziti likuiduan vëllëzërit e tyre që me këtë të lirohen nga konkurentët dhe pretenduesit për fron (Köprülü, "*Les Origines...*" f.129). Vrasja e vëllëzërve nga arsye të njejta është bërë edhe më vonë tek osmanlinjtë.

<sup>38</sup> Sikur në të gjitha rastet e ngjashme, kjo shprehje arabe, një testimonia ignorantiae e zakonshme edhe këtu tregon se shkrimtari nuk merrë kurrfarë përgjegjësie për këtë pohim.

Përsa i përketë sulltan Barkukut, Jelbog Nasirit<sup>39</sup> ai u ngrit kundër tij e çfarë fati e gjeti sulltan Barkukun u tha më lartë.

Prandaj, atë që Muhammedi a.s. ia kishte thënë në ëndërr ajo u realizua me të dy sundimtarët ("*Bazm u razm*", f. 384, rreshti 1)<sup>40</sup>.

Ajo që pason në "*Ahengu dhe lufta*" nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me temën tonë, por i sqaron disa imtësi të tregimit të lartëtheksuar të ëndrrës së sulltan Ahmedit për fatin e Muradit të parë. Në të vërtetë, sulltani i Sivasit kishe parë në ëndërr Muhammedin a.s. me veshje të një dervishi të tarikatit ahmedij, për shkak se ai, pikërisht në ato ditë i kishte dhuruar tyrbes së shejh Sadruddin Konjeviut (nga Konja) dy qylyma të shtrenjtë, pas të cilës dervishi i asaj tyrbeje i dërgon atij një ekzemplar të veprës "*Fusulul-hikam*" ("*Pelikanët e urtisë*")<sup>41</sup>, nga shkrimtari i mirënjohur mistikë arab Muhiddin Arabiu (1165-1240)<sup>42</sup>, e atë ekzemplar gjatë jetës së vetë e kishte përshkruar i njëjti për shejh Sadruddin Konjeviun (vdiq më 1273), nxënësi i tij kryesor dhe njëherit komentatori që ishte varrosur në tyrbe.

---

<sup>39</sup> Ky ka qenë mëkëmbës i Barkukut në Halep. Kundër tij dhe aleatit të tij Mintashit, sulltani dergoi ushtri të madhe, por ajo u thye të Damasku në pranverën e vitit 1389. Jelbogë dhe Mintashi ikën në Egjipt, sulltani vet u dorëzua dhe mbeti në robëri (*Enzyklopaedie des Islam*, f. Barququ, H. Edhem, vep. e cit. f. 108, etj).

<sup>40</sup> Në të vërtetë, pasi humbi tek Damasku në vitin 1389, Barkuku ra në robëri të mëkëmbësi i tij Jalbogu dhe e humb fronin, kurse për Muratin e dijmë se po atë vit u vra. Për Barkukun dhe makinacionet e tij kundër mamelukëve të fundit të degës bahrite, krahaso: Aug. Myller, vep. e cit. libri II, f. 249 dhe 297.

<sup>41</sup> Kjo vepër flet për rëndësinë dhe esencën e 27 pejgamberëve, e është shkruar pas ëndrrës së shkrimtarit në të cilën kishte pare Muhammedin.

<sup>42</sup> Ky vizionar pretencioz, besimkotë i çuditshëm dhe orator i madh i kultit të njeri në disa rrethe mjaft i popullarizuar. Megjithatë, dy orientalistë të shkelqyshëm, edhe pse ia pranojnë në një masë entuziazmin, fantazinë dhe zhdërvjelltësinë letrare, Ibn Arabiun e konsiderojnë gati mashtroes (Alfred von Kramer), respektivisht deri në një masë sharlatan (Reynold A. Nicholson). I pari e ka studiuar dhe treguar mjaft gjërë në veprën e vet "*Geschichte der herrschenden Ideen des Islams*" (Leipzig 1868, f. 102-109), e tjetri në veprën e tij "*A Literary History of the Arabs*" (botim i 3, Londër 1923, f. 399-404). Mirëpo, orientalisti anglez, i cili kishte botuar dhe përkthyer tërë "*Mesnevinë*" e Xhelaluddin Rumiut në gjuhën angleze dhe i cili ka shkruar mjaft për mistikët arabë dhe persianë, tregon mjaft maturi në vlerësimin e këtij mistiku aq sa studimet detale nuk japin rezultatet më të sigurtat. C. Brockelmann në veprën "*Geschichte der Arabischen Litteratur*" (libri I, Ëëimar 1898, f. 441) nuk hyn aq guximshëm në idetë e çuditshme të Ibni Arabiut, sa në të dhënat biografike, ndërsa Erster Supplementband (Leiden 1937, f. 790, dhe në vazhdim), krahas literaturës së tij ka përplot të dhëna bibliografike për veprat e këtij mistiku dhe për komente në disa punime të tij. Te ne për Ibni Arabiun ka shkruar A. Adil Qokiq në "Novi Behar", v. IX, f. 159 dhe në vazhdim (në pesë numra).

Pas këtij sqarimi "*Ahengu dhe lufta*" kalon në ekspozitë të ngjarjeve të ndryshme nga jeta e trazuar e sundimitarit të Sivasit, ngjarje të cilat po ashtu nuk janë në lidhje të drejpërdrejtë me lëndën e këtij artikulli. por, në fund të faqes së katërt pas atij vendi në të cilin u vra Muradi që u theksua pakë më lartë, Astarabadi përsëri i kthehet të njëjtës ngjarje dhe e përmend shumë shkurtë gati me të njëjtat fjalë (f. 387, rreshti 4 nga fundi) 39, që në përkthim dmth. "Atëherë Murad begu u nis në luftë kundër pabesimtarëve dhe atje mbeti i vvarë si shehid".

Në pasuesin vijues, biografi i sulltanit të Sivasit, thotë shkurtë se në vend të sulltan Muradit "u vendos biri i tij Bajazid begu", duke mos u lëshuar në kurrfarë sqarimi për vrasjen e sulltan Muradit në Betejën e Kosovës.

Mirëpo, edhe pse "*Ahengu dhe lufta*" me të shpejtë dhe për çudi me një gjuhë të natyrshme lajmëron për fundin e sulltan Muradit, megjithatë ajo gjatë flet për pasardhësin e tij sulltan Bajazidin I (1389 - 1400) dhe kjo këtu neve na interson për shumë arsye. Jo vetëm pse historia osmane, siç ka theksuar Çedomir Mijatović, menjëherë pas asaj kombëtare mund të na interesoj më shumë, por edhe për shkak se ky i "rrufeshmi", ose, siç thotë Konstandin Filozofi, perandori "rrufe-vetëtim" mori pjesë në Betejën e Kosovës, ku me rrufeshmërinë dhe shkathtësinë e vet e shpëtoi ushtrinë osmane nga humbja dhe me atë fitore arriti pushtetin suprem mbi shtetin serb dhe u bë dhëndër i princeshës Milicë, duke ia marrë asaj, kundër dëshirës, vjazën Olivera për grua.

Pas qëndrimit të shkurtër në fronin e babait, vazhdon Astarabadi, Bajazidi i pa përvojë u rrethua nga armiqtë dhe gati secili princë fqinjë (në Anadoll) ia shkëputi nga një pjesë të vendit, ndonjë kështjellë a ndonjë qytet emrat e të cilëve theksohen dhe vetëm me ndihmën e Sylejman pashës i shkoi për dore që t'i qetësoj dhe t'i nënshtrojë kundërshtarët dhe kështu ta rregulloj dhe siguroj trashëgiminë e vet nga babai. Mirëpo, tani, pikërisht ky Sylejman pasha që i ndihmoi aq shumë sulltan Bajazidit, Astarabadi shprehet mjaft pa përshëmtim për Jëlldërëmin, largohet nga ai dhe dëshiron t'i bashkangjitet sulltan Ahmedit nga Sivasi.

Në ç'ka qëqndron ajo kritik e ashpër kundër Bajazidit dhe sjelljeve të tij kundër Bajazidit? Parasegjithash, "*Ahengu dhe lufta*" potencojnë se ai sulltan osman, sipas vlerësimit të atyre që kishin fituar përvojë me të - as nuk i respekton edhe në qoftë se me ndonjërin ka ngrënë bukë e krip, e as nuk vlerëson mikun e vërtetë, më tutje, ai nuk ka aq mend sa të mund të dalloj mikun ng armiku, e as dituri që të dalloj të mirën nga e keqja, as rezon që të fal dhe të përkldhel kur sheh

dëgjueshmërinë, as që ka përgjithësisht arsye atje ku duhet patur etj. ("*Bazmë u razm*", f. 388, reshtat 5-22)<sup>43</sup>.

"*Ahengu dhe lufta*" flet edhe për imtësitë e tjera që kanë të bëjnë me Bajazidin dhe për luftërat e tij me emirë të ndryshëm në principatat ende të pavarura të Azisë së Vogël, mirëpo, kjo më nuk ka lidhje me Betejën e Kosovës as me temën e artikullit prandaj, me këto karakteristika të Bajazidit që i ofron Astarabadi do të përfundojmë përkthimin, përkatësisht komentimin e këtij burimi historik në gjuhën perse.

Në qoftë se tani i hedhim një vështrim lajmeve të lartëtheksuara dhe të dhënave në veprën "*Ahengu dhe lufta*" do të shohim se ato në esencë (pa marrë parasysh detajet) mund të përmbliken në tri tema vijuese:

Propozimi i princërve mongolë që të sulmohen krahinat e sulltan Muradit, derisa ky ishte i zënë në fushatën luftarake në Kosovë me "pabesimtarët";

Ëndrra e sulltan Ahmedit për fatin e sulltan Muradit dhe të sulltan Barkukut dhe realizimi i asaj ëndrre (vrasja e sulltan Muradit);

Karakteristikat e sjelljeve të sulltan Bajazidit menjëherë pas Betejës së Kosovës.

Për aq sa na kujtohet këto tri tema nuk janë shqyrtuar njëjtë as për nga masa që përfshihen në veprën "*Ahengu dhe lufta*", as për nga rëndësia e të dhënave që mund të kenë për historinë tonë. Tema e parë është treguar mjaftë gjërë. Mirëpo pjesa më e madhe e këtij tregimi i është kushtuar shqyrtimit të shkaqeve përse sulltan Ahmedi nuk u pajtua me propozimin e princërve mongolë. Megjithatë ai artikull përmban diçka që ka mundur të ndikoj në fushatën e sulltan Muradit kundër të krishterëve në Ballkan po t'i kishte dëgjuar sulltani i Sivasit princërit mongolë dhe ta sulmonte vendin e sulltan Muradit, ky i fundit do të detyrohej që sa më parë të kthehej prapa për të mbrojtur prapun e shtëpisë së vet në vend që të sulmonte vendet e huaja. Të mos paragjykojmë ç'farë do të ishte bërë po të ndodhte ajo që nuk ka ndodhur, por të kalojmë në temën tjetër.

Marrë më saktësisht në këtë temë kemi të bëjmë me një grup të vogël të të dhënave që i kanë paraprirë vrasjes së sulltan Muradit si temë kryesore. Si rëndomë tek njerëzit e orientit, kështu edhe në veprën "*Ahengu dhe lufta*" ëndrrat luajnë rol të rëndësishëm: ato e nxitin dhe e trimërojnë sulltan Ahmedin që të merr vendim për diçka dhe që sa më parë ta realizojë, ose t'ia tërheqë vërejtjen dhe ta kthej nga

---

<sup>43</sup> Sa është rezymeja e Kilisli Rifatit, në disa raste jo e mjaftueshme, shihet edhe në kë vend ku përmbajtja, po ashtu e shkurtuar, është përfshirë në këto katër fjalë "mallkimi i Bajazit beut" (krahajo "*Bazm u razm*", shtesa, f.31, në mes).

diçkaja atë që e ka ëndrruar. Në këtë ëndërr - në qoftë se ky detaj i Astarabadit nuk paraqet *vaticinium ex eventu* të rëndomtë - sunduesi i Sivasit që më parë e ka ditur fatin e të dy sundimtarëve me të cilët kishte pasur mjaftë probleme, e kjo ishte mjaft e rëndësishme për planet dhe vendimet etij.

Mirëpo, për ne është e rëndësishme ose më interesante ajo që thotë Astarabadi menjëherë pas konstatimit se ëndrra u bë realitet dhe se sulltan Muradi u vra, kjo do me thënë pohim se ai u vra me porosinë e birit të vetë, Bajazidit! Me sa di, kjo është tërësisht e dhënë e re dhe e panjohur, e të mos flasim për faktin se sa është e paverifikuar dhe e paargumentuar. Këtu nuk mund të themi se është e "paprtitur" dhe e "pamundur", sepse në luftërat për fron janë shënuar krime të ndryshme jo vetëm tek osmanët por edhe tek shumë popuj të tjerë.

Ai detaj i Astarabadit për të dhënë se pse pejgamberi a. s. në ëndrrën e sulltan Ahmedit u paraqit me pamjen e dervishit ahmedij mund të jetë kontribut i dobishëm për njohjen dhe shtrirjen e këtij tarikati, por për qëllimin tonë nuk ka kurrfarë rëndësie. Që vepra "Ahengu dhe Lufta", pas këtij sqarimi, edhe njëherë e potencon vrasjen e sulltan Muradit, kjo thjesht është përsëritje nga e cila nuk mund të mësojmë asgjë të re dhe të panjohur.

Më në fund tema e tretë karakterisitikat e Bajazidit është analizuar sa që për afërsisht nuk përputhet me tregimet e rëndomta të jetës dhe të veprës së pasardhësve të sulltan Muradit, në të cilat më së shumti potencohen guximi i Bajazidit, qëndrimi energjik dhe pushtimet e shpejta ("të rrufeshme") të Serbisë, Maqedonisë, Bullgarisë, Shqipërisë dhe principatave të tjera të Azisë së Vogël, dëpërtimi (osmanët në kohën e tij dëpërtuan në Shtajerskë, Bosnjë dhe Atinë) dhe rrethimet e gjata (p.sh. Stambolli shtatë vjet), e sidomos fitorja e tij epokale mbi krishterët e bashkuar te Nikopoja (1396).

Në qoftë se diçka mund t'i shihet për të keqë këtij sulltani atëherë ajo do të ishte mendjemadhësia, e cila e kaploi aq shumë sa që e nënçmonte armikun dhe nuk u përgatit mirë për luftë kundër Timurlenkut në betejën e Ankarasë<sup>44</sup> e kjo vlenë për sjelljen e Bajazidit një dekadë të tërë që nga Beteja e Kosovës. Në asnjë rast nuk duhet harruar se tiparët e padëshiruar të sulltanit të ri si dhe ai pohimi se ai ka urdhëruar vrasjen e babait në Kosovë - rrjedhin nga biografi i sulltanit të Sivasit, i cili ishte në armiqësi dhe në gjendje lufte me pasardhësin e Muradit.

Përgjithësisht, qortimi dhe gjykim i sapopërmendur i Bajazidit I, si dhe ato që u thanë më lartë për sulltan Muradin, si një mongolë i thjeshtë dhe i paditur në të

<sup>44</sup> Aug. Myller, vep, e cit., II, 303.

vërtetë janë shprehje e animozitetit dhe urrejtjes së madhe të Astarabadit, përkatësisht inspiruesit të tij sultan Ahmedit ndaj osmanlinje si armiqë politikë. Për ndjenja të këtilla kundër osmanëve si armiq tonë të dikurshëm ka edhe në historinë dhe letërsinë tonë. Të kujtojmë vetëm atë se si Lubomir Nenadoviçi në vjersh i ka mallkuar osmanët, si dhe Skerliqi, i cili ka theksuar shembuj për atë se "poetët e ri janë të disponuar kanibalisht kundër turqve"<sup>45</sup>. Shembuj të tjerë të urrejtjes serbe kundër turqve, nga poetët bashkëkohor, ka theksuar V. Çoroviçi në veprën e tij "Bosnja dhe Hercegovina", (f. 65).

Vetëm më vonë, nën ndikimin e shkrimtarëve orientalistë gjerman, "shkrimtarët tonë turkofobë, sikur që mund të mendohet, u bënë paradoksalisht idhujtarë të poezisë myslimane"<sup>46</sup>.

Kjo urrejtje ndaj turqve është shtrirë edhe tek ata që vetë e kanë pranuar islamin nga osmanët, d.m.th. të boshnjakët. Siç thotë Antun Borac<sup>47</sup> këta (turqët) janë urrejtje e letërsdisë serbo-kroate në gjysmën e parë të shek. XIX, urrejtje e cila ka lindur nën ndikimin e poezisë popullore; shembuj të mirë për nivelin e asaj urrejtje, vazhdon Boraci, janë "Vdekja e Smaji agë Çengićit" dhe disa vepra të tjera me glorifikimin e vrasjeve në mes veti; në tërë novelistikën e atëhershme, përfundon i njëjti kritikë, "turku" është vetëm zullumqarë e jo njeri, vetëm Batiçi e thekson atë njerëzorën tek "turqit" (Fazli Begu në "Pobratimet", etj., me këtë mbaron likuidimi i modes letrare, urrejtja ndaj vëllezërve përshkak të fesë.

Nga ana e tjetër, urrejtja politike nuk ishte e panjohur as për osmanët. Ata ndjenin urrejtje të madhe kundër shtetëve katolike, e sidomos kundër Spanjës, për shkak të ndjekjes së maurëve nga Spanja si dhe për shkak të humbjes së madhe të Leponti (1571), etj. Siç thekson F. V. Haseluck<sup>48</sup> këtë gjendje e shfrytëzuan shtetet protestane (Anglia dhe Holanda): Konventa e parë angleze me Portën daton që nga viti 1581. Spanja atëherë nuk kishte as përfaqësuesin e vetë në Stamboll. Kjo edhe më shumë vërehet se rryma turkofile në shekullin e XVI ka qenë shumë e fortë gati në gjithë Evropën<sup>49</sup>.

---

<sup>45</sup> "Omladina i njena knjizevnost" (1848-1871), Beograd 1906, f.228-229 dhe 536-7.

<sup>46</sup> Skerliq, vepra e njëjtë, f.377.

<sup>47</sup> "Hrvatska revija", IV (Zagreb 1931), f.533-4, në artikullin Botiq kao pjesnik.

<sup>48</sup> *Christianity and Islam under the Sultans*, Oxford 1929, libri II, f.723 (për këtë vepër të rëndësishme në dy libra kam shkruar gjërësisht dhe për përmbajtjen e disa artikujve në Srpski knjizevni glasnik, I.XXXII, 1931, f.556-561 dhe 641-649).

<sup>49</sup> Agatangel Krimski, në veprën e tij "Historia tureqini" (Kiev 1924 në ukrainishte) ia kushtron një kapitull të tërë (f.200-221) asaj turkofileje; krahaso edhe recensionin tim të këtij libri me *Mitteilungen zur osmanischen Geschichte*, libri II, (1929), f. 335-337. Mendime të mira për turqit gjenden tek shkrimtari i njohur arab Xhahizi (vdiq me 869), i

Mirëpo, pas këtyre shembujve të urrjetjes sonë të dikurshme, ndaj osmanëve dhe mos durimit osman ndaj spanjollëve të asaj kohe, shembuj këtu që u përmenden, vetëm si paralele të animozitetit të Astarabadit kundër Muradit I dhe të Bajazidit I, kthehemi aty ku mbetëm.

Krahas detajeve, që më parë u theksuan, në tre temat e tregimit të Astarabadit, për lajmet që kanë të bëjnë me Betejën e Kosovës, mirëpo ato që më së shumti i kemi pritur, dmth. të dhënat më të përafërta për Betejën e Kosovës - ato aty janë treguar shumë pakë, e mbase edhe mjaftë shkurtë. Natyrisht nga Astarabadi nuk duhet pritur detaje të cilat as Konstandin Filozofi nuk i ka ofruar<sup>50</sup>, mirëpo, nga ana tjetër, ai mbetët shumë prapa me tregimin e Shukrullahut dhe Uruxhit. Nuk duhet harruar se lëndë e veprës "Ahengu dhe Lufta" është jeta dhe vepra e sunduesit të Sivasit e jo historia e sulltanëve osmanë, pushtimet dhe betejat e tyre.

Pranë të gjitha mangësive dhe papërcaktueshmërive në tregimin e Astarabadit për Betejën e Kosovës, më saktësisht për vrasjen e sulltan Muradit, e në lidhje me të çdo burim për këtë ngjarje epokale, sidomos një orientalistë i panjohur bashkëkohor, mund të tërheq vëmendjen dhe të nxitë interesimin tonë ky tregim nuk është larg mendësh dhe jo i padobishëm, sidomos për disa detaje në lidhje me këtë ngjarje që nuk gjenden në burime të tjera. Në fund të fundit rezultati edhe i varfër, e bile edhe negativ i një hulumtimi të këllillë është i dobishëm për shkencën, së paku në atë masë sa që pas punës së kryer dhe mundit të investuar mund të thuhet se burimi i theksuar, në këtë rastë "Ahengu dhe Lufta" e Astarabadit është përpunuar së paku për atë që ka të bëjë me vrasjen e sulltan Muradit në fushën e Kosovës dhe të tjera që janë me vlerë në lidhje me atë ngjarje të rëndësishme.

*Nga POF, 3-4, 1952, Përktheu: Ismail REXHEPI*

---

cili ka shkruar për ta një shqyrtim të shkurtër. (shih: Cl. Huart, *Geschichte der Araber, autorisierte Übersetzung von Sebastian Beck und Moritz Farber*, libri I, Leipzig 1914, f. 302).

<sup>50</sup> Për krahasim. po japim pjesë nga Konstantini: "Në mesin e ushtarëve që luftuan në atë ushtri, ishte njëri shumë i frytshëm (Millosi), të cilin e spiunuan te sundimtari i tyre dhe e paraqitnin si tradhtar. E ky që ta tregojë besimin. e njëherit edhe trimërinë. gjeti kohë të përshtatshme, drejtohet kah sundimatri kundërshtar sikur dezertor. dhe atij ia hapin rrugën. E kur u afrua. befás nxjerr shpatën dhe sulmon sundimtarin e ashpër" dhe ia nguli shpatën. Siç po shihet. emri i Milloshit (Obiliqit) aspakë nuk theksohet, por sipas asaj që nënkuptohet. përkthyesi i Zhivota despota Stafana Lazareviq. dr. Lazar Mirkoviq (botim i *Srpske knjizevne zadruga*, Beograd 1906, f. 59) e ka dhënë në kllapa. Konstantini jep edhe detaje tjera për betejën. bile edhe datën e sakt, por, p.sh. asgjë nuk jep për vrasjen e Jakubit. vëllai i vetëm i Bajazitit. etj.

LA BATAILLE DE KOSOVO D'APRES UNE SOURCE PERSANE  
CONTEMPORAINE

*Resumé*

Parmi les rares sources historiques relatives aux commencements de l'Empire Ottoman (XIV-e siècle), écrites en langues orientales (islamiques), quelques-unes seulement contiennent plus ou moins de renseignements sur la bataille de Kosovo en 1389. Le fragment qui fait partie de l'épopée historico-romanesques İskender-nâme d'Ahmedî, terminée en 1390, peut être considérée comme la source la plus ancienne. Les deux autres sources turques les plus anciennes relatives à cet événement sont l'*Histoire générale* par Shukrullah et l'*Histoire de la dynastie de Osmân* par Uruğ; mais elles ont été composées quelques soixante-dix ans après cette bataille. Cependant, la biographie du sultan Ahmed Burhânuddîn de Sivas, écrite en persan sous le titre *Bâzm u râzm* (*Banquet et Combat*) par l'historiographe de la cour Astarâbâdî et terminée en 1397-98, contient certains renseignements touchant cette catastrophe, dont la relation serbe la plus ancienne, celle de Constantin Philopophe, ne remonte qu'à quarante ans et davantage (1431) après la bataille même.

Après avoir donné les éclaircissements nécessaires relativement au contenu principal de *Banquet et combat* par Ahmed Tevhîd (TOEM, tome V, numéros 26-32), puis à l'édition de cette oeuvre (1928) par kilîslî Rif'at, avec son résumé des événements principaux (en turc), et après avoir souligné que Heinz H. Giesecke avait communiqué (1940) un contenu assez détaillé de la même oeuvre, l'auteur de cet article en rapporte ou traduit les fragments relatifs à cette bataille, à la mort sur le champ de bataille du sultan Murâd et à tout ce qui a trait à cet événement. À ce propos, l'auteur de l'article ramène tous ces renseignements aux trois thèmes (groupes de renseignements), à savoir: 1) la proposition des princes mongols faite au sultan Burhânuddîn, d'envahir avec lui les pays de Murâd pendant que celui-ci combat les "infidèles"; 2) le rêve du sultan Burhânuddîn sur les destinées du sultan égyptien Barquq et de Murâd I: et la réalisation de ce rêve (au cours de cette même année, le premier a perdu son trône et le second sa vie); 3) la description et la stigmatisation du comportement de Bâyezîd immédiatement après la bataille de Kosovo.

En considérant d'une manière critique ces trois groupes de données, le professeur Bajraktareviq relève que le premier thème est traité d'une manière assez détaillée, mais qu'il ne contient, malgré cela, en général, que les raisons pour lesquelles Burhânuddîn avait refusé cette proposition; c'est seulement dans le

kasoû la proposition eût été accepté, dit l'auteur, que nous aurions eu une situation critique, puisque Murâd I: aurait dû renoncer à la guerre contre les "infidèles" et rentrer dans son pays. Quant au deuxième groupe de données, l'auteur souligne que ce rêve ou sa réalisation (c'est-à-dire la défaite et le détournement de Barqûq respectivement la mort de Murâd) ont pu influencer les plans et les décisions de Burhânuddîn, mais aussi que la description même de la bataille est très courte et assez pauvre et qu'elle ne contient rien de nouveau et d'inconnu, excepté l'assertion que Murâd, par ordre de Bâyezîd, est tué par quelques serviteurs. En ce qui concerne le troisième groupe (thème), il contient une description tout à fait défavorable de Bâyezîd et elle provient d'un certain Suleymân-pacha, qui l'a aidé à assurer, dans le combat contre ses vassaux rétifs, sa succession au trône après son père, mais on y sent l'animosité d'Astarâbâdî, -que déjà dans le premier groupe de renseignements qualifia même Murâd de "Mongol vulgaire et ignorant"— et, en général, la haine contre les Turcs en tant qu'ennemis politiques. Par un parallélisme, l'auteur de l'article se réclame de l'ancienne haine des Yougoslaves (pour les mêmes raisons) contre les Turcs qui s'est manifestée dans l'histoire et dans la littérature, aussi bien que de la haine des Turcs contre les Espagnols d'alors (à cause de l'Expulsion des Maures d'Espagne, etc.)

A la fin, l'auteur de l'article conclut que certains renseignements d'Astarâbâdî sont intéressants, nouveaux, inattendus même, tandis que ceux relatifs à la bataille même sont très courts et assez pauvres; mais pourtant il pense que ce travail et cette sorte d'études ne sont pas sans profit, car il y est traité d'une source historique orientale tout à fait inconnue chez nous (et de plus contemporaine), au moins dans la mesure où elle se rapporte à la mort de Murâd à Kosovo et à tout ce qui touche cet événement important.

.